



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit me Karakter Profesional në:
"Asistent Ligjor dhe Administrativ"
Kolegji Universitar "Qiriazi"**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Gentiana Kraja

Dr. Valbona Ndrepepaj

Tetor / 2024

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
me karakter profesional në: "Asistent Ligjor dhe Administrativ"

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar "Qiriazi"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i së Drejtës Civile dhe Biznesit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Diplomë Profesionale në "Asistent Ligjor dhe Administrativ"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MAS Nr. 384, datë 08.07.2022
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Program studimi me karakter profesional
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite (4 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5 (pestë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	v.a 2022-2023 12 PAE/ 0 PAK v.a 2023-2024 16 PAE/0 PAK
18	Numri i studentëve:	V.a 2022-2023 20 studentë V.a 20232024 14 studentë
19	Komente / të tjera:	-

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Qëllimi i procesit të vlerësimit të jashtëm është të japë një mendim të pavarur për shkallën në të cilën institucioni në fjalë është i përgatitur dhe i angazhuar të përmbushë me efektivitet dhe përgjegjshmëri kërkesat dhe standardet akademike të diplomave që do të lëshojë. Për të arritur në këtë gjykim, GVJ u mbështet në shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, në dokumentacionin bazë mbi të cilin ngrihet veprimtaria e IAL-së (Kolegjit), dosjen e programit të studimit me dokumentacionin shoqëruar si dhe takimet e vizitat e organizuara në institucion. Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e sillabuseve: vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kompetencën e personelit akademik, aktivitetin kërkimor - shkencor dhe atë ekstrakurrikular, kujdesin ndaj studentit, këshillimin e karrierës dhe tutoriatin, praktikën profesionale, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe projektet, etj.

Kolegji Universitar "Qiriazi", (këtu e në vijim me shkurtimin KUQ) e ushtron aktivitetin e tij bazuar në Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe të akteve të tjera nënligjore mbi arsimin e lartë, Statutin e Kolegjit, Rregulloren bazë të tij dhe të akteve të tjera rregullatore të institucionit.

Një nga njësitë kryesore të KUQ është edhe Fakulteti i Drejtësisë, në përbërje të të cilit është Departamenti i së Drejtës Civile dhe Tregtare, si njësi bazë e tij. Një nga programet e studimit që ofron ky departament është dhe programi i studimit me Karakter Profesional "*Asistent Ligjor dhe Administrativ*", objekt i këtij procesi (vlerësimi). Ky program studimi zgjat dy vite akademike, është me kohë të plotë, ofrohet në shqip dhe në përfundim të tij studenti merr 120 kredite ECTS dhe pajiset me një diplomë profesionale.

Më konkretisht, ky program studimi me Karakter Profesional "*Asistent Ligjor dhe Administrativ*", është licencuar me Urdhrin nr.384, datë 08/07/2022, "*Për hapjen e programit të studimit me karakter profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ" në Kolegjin Universitar "Qiriazi", të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Veprimtaria e tij akademike ka filluar në vitin akademik 2022-2023.*


Ky program studimi, sipas nivelit 5 (pesë) të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, synon të, krijojë mundësi për shkollim dhe trajnim të mëtejshëm studentëve të ardhshëm. Më konkretisht, është një program studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e KU "Qiriazi", si edhe në përputhje të plotë me bazën ligjore sektoriale të arsimit të lartë.

KUQ, bazuar në Planin strategjik të zhvillimit të tij, në kërkesat ligjore, dhe nevojat e tregut të punës në vend, ku ofrimi i kualifikimeve profesionale është prioritet, ka vendosur të kërkojë vlerësimin këtij programi.

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al



Ky program, si dëshmohet, ka si synim të përgatisë një profil asistenti, i aftë të marrë përgjegjësi dhe të jetë në gjendje të menaxhojë në autonomi zyra të burimeve njerëzore, sekretaritet administrative apo aparatit tekniko- funksional të zyrave ligjore, kontabilitetit etj.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Pasi KUQ ka aplikuar për nisjen e procedurës së vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional, "Asistent Ligjor dhe Administrativ", ASCAL bazuar në "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë nëkuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017", ka përzgjedhur dhe kontraktuar dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Kolegji, për të kryer vizitën në institucion dhe për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof.asoc. Dr. Gentiana Kraja dhe Dr. Valbona Ndrepepaj, profesore përkatësisht në Universitetin e Durrësit dhe Tiranës. Gjatë vizitës në institucion dhe procedurës lidhur me vlerësimin e jashtëm, ekspertët e jashtëm u asistuan nga koordinatorja teknike e ASCAL Znj. Alma Arapi.

Ekspertëve të jashtëm iu vendos në dispozicion gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim, fizikisht dhe përmes platformës e-ASCAL. Gjatë vizitave ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë mbledhjesh për të kryer të gjitha takimet sipas agjendës së planifikuar. Në vlerësimin që ka bërë, GVJ ka qenë objektiv, i paanshëm dhe ka vlerësuar mbi bazën e dokumentacionit të sjellë nga IAL për këtë program studimi që i nënshtrohet akreditimit.

GVJ ka përcaktuar shkallën e përmbushjes për secilën fushë në 4 nivele sipas sistemit të standarteve të vendosur nga ASCAL për këtë qëllim. GVJ ka marrë kontakt sipas axhendës 2 ditore të vizitës në institucion. Ndaj, GVJ falenderon KUQ për bashkëpunimin dhe disponibilitetin e treguar gjatë vizitës për këtë proces akreditimi.

Duke vlerësuar arritjet dhe punën pozitive të bërë për këtë program studimi, në fund të këtij raporti, janë dhënë edhe rekomandimet për institucionin si dhe është paraqitur analiza SWOT për programin e studimit që është objekt akreditimi, me qëllimin e mirë për të ndihmuar në përmirësime të mundshme rregullatore, strukturore, organizimi dhe kompetencash për përmbushjen e standarteve dhe detyrimeve ligjore e statutore, si dhe arritjen e objektivave të kërkuar për një program studimi me karakter profesional.

Kolegji Universitar "QIRIAZI", është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 08.10.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 76 / 28 Prot, datë 08.10.2024. Kolegji Universitar "Qiriazhi", njofton në ASCAL më datë 15.10.2024, me anë të shkresës me Nr.08 Prot, datë 15.10.2024 " Kthim përgjigje për Draft

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të studimit me karakter profesional në: “Asistent Ligjor dhe Administrativ”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programi i studimit të me karakter profesional në “Asistent Ligjor dhe Administrativ” është një program studimi i cili ofrohet në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, Strategjinë për Arsimin e Lartë dhe të gjithë bazën ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Programet e studimit të KUQ janë në përputhje me Strategjinë Kombëtare të arsimit të lartë dhe planet strategjike të tij janë në përputhje me vlerat kombëtare. Në këtë kontekst programi i studimit të me karakter profesional në “Asistent Ligjor dhe Administrativ” është në përputhje me vlerat akademike dhe kulturore kombëtare. Programi i plotëson kriteret e këtij standardi dhe është në mbështetje të zhvillimit dhe mbrojtjes së interesave kombëtare.</p> <p><i>Shih: Ev. 1 1 Statuti i KU “Qiriazhi”, Neni 3.</i> <i>Shih: Ev. 2 5 Rregullore e FD, neni 5/4.</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Programi i studimit të me karakter profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ” është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit në përgatitjen e studentëve. Ky program studimi është dizenuar për të përgatitur studentë për një karrierë të suksesshme në sektorin Publik si dhe në menaxhimin e Marketingut por edhe në sektorin privat në nivel teknik e profesional. Thelbi i programit fokusohet në formimin e të menduarit kritik tek studentët, me</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

	<p>aftësinë për të menduar dhe vepruar njëkohësisht si dhe për të gjykuar situata specifike.</p> <p><i>Shih: Ev. 1_1 Statuti i KU "Qiriaz", "neni 3 germa "e", neni 35.</i> <i>Shih: Ev. 1_4 Rregullore e KU "Qiriaz", neni 23.</i> <i>Shih: Ev) 3_1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ", nenet 6, 16 dhe 17.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.</p>	<p>Programi i studimit të me karakter profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ" është hartuar dhe iu ofrohet studentëve në përputhje dhe në zbatim të Planit Strategjik të zhvillimit të Institucionit, KUQ. Drejtimit strategjike të zhvillimit të KUQ-it shprehen në Statutin e tij dhe në Planin të Zhvillimit Strategjik i Zhvillimit KU "Qiriaz"</p> <p>Statuti dhe rregullorja e KUQ si dhe rregullorja e Programit të studimit me karakter profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ" përcaktojnë drejtimit prioritare akademike të institucionit dhe demostrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me to. Programi i studimit me karakter profesional në "Asistent Ligjor dhe Administrativ" është hartuar për t'i ofruar studentëve përgatitjen e nevojshme në përputhje të plotë me fushën e studimit.</p> <p><i>Shih: Ev. 1_1 Statuti i KU "Qiriaz", neni 3germa "c".</i> <i>Shih: Ev. 1_4 Rregullore e KU "Qiriaz", neni 23.</i> <i>Shih: Ev. 1_3 Plani strategjik i zhvillimit KU "Qiriaz".</i> <i>Shih: Ev. 1_15 Strategjia për Kërkimin Shkencor, Projektet, Partneritetin.</i> <i>Shih: Ev. 3_1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ" neni 17.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional në Asistent Ligjor dhe Administrativ bazohet në dokumenta strategjike kombëtar dhe institucional. Plani strategjik institucional, ashtu siç shprehet është në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit, pasi reflektohet në planet mësimore, programet e lëndëve. Pra, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit të me karakter profesional në "Asistent Ligjor dhe Administrativ", përputhet me përcaktimet strategjike në nivel makro dhe mikro.</p> <p><i>Shih: Ev. 2_13 Studimi i Tregut.</i> <i>Shih: Ev. 1_34 Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit brenda dhe jashtë vendit.</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

	<p><i>Shih: Ev. 2_26_10_Model /template, Pyetësor për bashkëpunëtorë të KU "Qiriazhi".</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_26_8_Model /template, Pyetësor për gjurmimin e studentëve KU "Qiriazhi" (Alumni).</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të reflektuar në RVB, nga intervistat dhe vizita e bërë në ambientet e KUQ dëshmohej plotësisht se KUQ ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura për të menaxhuar dhe për të çuar përpara programin e studimit. Fakulteti i Drejtësisë sipas evidencës Ev. 2_27_1_ Informacion tabelor Staf.pdf përbëhet nga staf akademik 21 PAE/3 PAK. Nga të cilët: Prof. Dr. 1, Dr. 10, MSc 10 PAK: Prof. Asoc. Dr 2, MSc 1.</p> <p><i>Shih: Ev. 1_1_ Statuti i KU "Qiriazhi", Kreu IV, nenet 26-32.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 1_4_ Rregullore e KU "Qiriazhi" neni 99.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 1_24_ Infrastruktura mësimore e KU "Qiriazhi".</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_9_ Analiza vjetore e DDCT.</i></p> <p><i>Shih: Ev.-2_27_1_ Informacion tabelor mbi cilësinë e stafit mësimdhënës sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre për programin e studimit; Të dhëna sipas moshës; Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre.</i></p> <p><i>Shih: Ev.2_15_1 Marrëveshje MAS –KU "Qiriazhi", "Për përcaktimin e numrit të anëtarëve të personelit akademik".</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_27_2_ Informacion tabelor mbi numrin e personelit akademik për çdo njësi bazë: (PAE) dhe (PAK), titujt/gradat.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_27_3_ Informacion tabelor mbi Planin mësimor lidhur me personelin akademik përkatës për programin e studimit.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_28_ CV e stafit akademik të programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 6. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe</p>	<p>Fusha e programit të studimit është në përputhje të plotë me fushën akademike e kërkimore, ajo shprehet qartë edhe në emërtimin e programit të studimit i cili përputhet me atë të njësisë bazë dhe njësisë kryesore. Ky program studimi nga ana formale, por në një nivel të mjaftueshëm edhe nga përmbajtja është i hartuar në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, Manualit për Procedurat dhe Afatet për vlerësimin e cilësisë si dhe udhëzuesit e European Standards and Guidelines – ESG 2015. Klasifikimi dhe kodifikimi i programit të studimit janë sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e europiane. Organizimi i studimeve është në përputhje me nivelin 5 të KSHK – së si dhe përbëhet nga elementët e nevojshëm teorik dhe praktikë të formimit të specialistit në fushën administrative dhe ligjore. Ofrohet në 2 vite akademike dhe me 120</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

<p>udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>ECTS. Çfarë evidentohet në analizimin e programeve të lëndëve të këtij programi studimi është niveli i disi më i avancuar se nevojat e një programi profesional dhe deri diku mungesa e orëve të praktikës. Kodi i programit është 52PP0488S dhe është realizuar sipas direktivave përkatëse.</p> <p><i>Shih: Ev. 1_1 Statuti i KU "Qiriazhi" nenet 33-44.</i> <i>Shih: Ev. 3-1 Rregullore e programit të studimit.</i> <i>Shih: Ev. 1_4 Rregullore e KU "Qiriazhi", neni 12.</i> <i>Shih: Ev. 2_16_ Të dhëna për kodifikimin e programeve të studimit në FD.</i> <i>Shih: Ev. 2_7_ Rregullore DDCT, neni 3/2 germa b.</i> <i>Ref: KSHK Niveli 5.</i> Ref: Udhëzim Nr.31, datë 15.11.2022 "Për procedurat për Kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" https://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2022/11/Udhezim-Nr.31-date-15.11.2022-Kodifikimi-i-programeve-te-studimit-IAL-pdf.pdf <i>Ref.https://ëëë.asc.al/sq/akreditimi/procedurat-e-vleresimit-dhe-akreditimit</i> <i>Ref. https://ëëë.enqa.eu/ep-content/uploads/2015/11/ESG_2015.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>KUQ e ofron Programin i studimit me karakter profesional në "Asistent Ligjor dhe Administrativ" në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe</p>	<p>KUQ dëshmon të ketë përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e Programit të studimit me karakter profesional në "Asistent Ligjor dhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.asc.al

<p>mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Administrativ” i cili bazohet në dokumenta strategjike kombëtare dhe institucional dhe ofrohet nga Fakulteti i Drejtësisë i cili ka një eksperiencë relativisht të mirë në ofrimin e programeve të këtyre fushave. KUQ dhe Fakulteti i Drejtësisë dëshmojnë të kenë kapacitetet akademike dhe infrastrukturare të mjaftueshme për ofrimin e programit të studimit. Fakulteti i Drejtësisë sipas evidencës Ev. <u>2_27_1</u>_Informacion tabelor Staf_i.pdf përbëhet nga staf akademik 21 PAE/3 PAK. Nga të cilët: PAE: Prof. Dr. 1, Dr. 10, MSc 10 PAK: Prof. Asoc. Dr 2, MSc 1. <i>Shih: Ev. <u>1_4</u>_Rregullore e KU “Qiriazhi”, neni 12.</i> <i>Shih: Ev. <u>2_8</u>_Programi i veprimtarive kryesore i DDCT.</i> <i>Shih: Ev. <u>2_9</u>_Analiza vjetore e DDCT.</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>KUQ në kuadër të implementimit të objektivave dhe strategjisë për zhvillimin institucional ka bërë pëpjekjet e duhura për mundësimin e bashkëpunimit ndër-institucional në plan kombëtar dhe ndërkombëtar. KUQ ka 94 marrëveshje bashkëpunimi brenda dhe jashtë vendit kryesisht në përmbushje të detyrimit të praktikës profesionale të studentëve. Në funksion të praktikave profesionale për pjesën e shoqërive tregëtare është në mënyrë të veçantë funksionale ‘praktika.al’ e cila vë në shërbim të praktikave 295 marrëveshje bashkëpunimi për studentët e KUQ. Marrëveshjet janë relizuar në kuadër të aktualizimit dhe profesionalizimit të studentëve si dhe në kuadër të procesit të ndërkombëtarizimit. <i>Shih: Ev. <u>1_34</u>_Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit brenda dhe jashtë vendit.</i> <i>Shih: Ev. <u>1_4</u>_Rregullore e KU “Qiriazhi”, neni 104.</i> <i>Shih: Ev. <u>2_10</u>_Rregullore e QKSH të FD.</i> <i>Shih: Ev. <u>1_32</u>_Politika e kërkimit shkencor. Puna kërkimore-shkencore tri vjeçare në KU “Qiriazhi”.</i> <i>Shih: Ev. <u>2_9</u>_Analiza vjetore e DDCT.</i> <i>Ref. https://praktika.al</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për</p>	<p>KUQ në funksion të realizueshmërisë së objektivave të programit të studimit ka mundur marrëveshje për të realizuar praktikat profesionale nga studentët. Këto marrëveshje janë realizuar me biznese, me bankat e nivelit të dytë, kompani sigurimi, institucione publike të qeverisjes vendore dhe qendrore, kompani auditimi etj. KUQ ka 94 marrëveshje bashkëpunimi brenda dhe jashtë vendit kryesisht në përmbushjen e detyrimit të praktikës profesionale të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al


Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

<p>realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.</p>	<p>studentëve. Në funksion të praktikave profesionale për pjesën e shoqërive tregëtare është në mënyrë të veçantë funksionale ‘praktika.al’ e cila vë në shërbim të praktikave 295 marrëveshje bashkëpunimi për studentët e KUQ. Marrëveshjet janë relizuar në kuadër të aktualizimit dhe profesionalizimit të studentëve si dhe në kuadër të procesit të ndërkombëtarizimit. Në favor të Fakultetit të Drejtësisë dhe të dy programeve të studimit janë 67 marrëveshje. Departamenti ndërmjet një procedure të mirëpërcaktuar administrim procesin e realizimit të praktikave mësimore që nga evidentimi i njësive dhe institucioneve të praktikave, lidhje e studentit me institucionin e deri në përfundimin me sukses të saj. Kjo procedurë është e rregulluar edhe ndërmjet dokumentacionit përkatës. Procedurat e zhvillimit të praktikave profesionale janë të rregulluara nëpërmjet akteve të brendshme, në të cilat janë parashikuar si procedurat që duhet të ndiqen ashtu edhe roli i aktorëve dhe njësive të ndryshme të përfshira në këtë process (Udhëzuesi i praktikave). Ndërkohë konstatohet që për shkak të karakterit profesional të programit të studimit praktika duhej të kishte pjesë në planin mësimor lëndor.</p> <p><i>Shih: Ev. 1_4_Rregullore e KU “Qiriazi”, neni 28.</i></p> <p><i>Shih:Ev.1_34_Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit brenda dhe jashtë vendit.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_10_1 Veprimtaritë, aktivitetet të QKSH të FD.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_36_ Informacion tabelor mbi Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi studimi për Praktikat profesionale me institucionet;</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_37_Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_26_5_Formular i vlerësimit të studentit praktikant.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 3-8-17 Praktikë profesionale</i></p> <p><i>Shih: Ev. 3-9 Udhëzues i Praktikave.</i></p> <p><i>Ref. https://qiriazi.edu.al/klinika-ligjore/</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në</p>	<p>Nga KUQ, Fakulteti i Drejtësisë dhe nga departamenti përkatës hartohet analiza vjetore e cila evidenton ecurinë e performancës akademike dhe mësimore të programit të studimit. Gjithashtu, njësitë kryesore periodikisht raportojnë pranë senatit akademik të KUQ lidhur me ecurinë e bashkëpunimeve me partnerët alternativë. Në këtë kuadër analizohet edhe ecuria dhe përfitimet e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al



<p>funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të programit të studimit.</p> <p><i>Shih: Ev. 2_9_Analiza vjetore e DDCT.</i> <i>Shih: Ev.2_36_ Informacion tabelor mbi Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi studimi për Praktikat profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë .</i> <i>Shih:Ev. 1_34_Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit brenda dhe jashtë vendit.</i> <i>Shih: Ev. 2_10_1 Veprimtaritë, aktivitetet të QKSH të FD.</i> <i>Shih: Ev. 1_34_1 Projekte: Erasmus+</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>Nga ana e strukturave përkatëse si Departamenti si dhe përfaqësuesit e Zyrës së Këshillimit të Karrierës bëhen përpjekje të vazhdueshme në drejtim të punësimit të studentëve. KUQ ka marrë pjesë si organizon aktivitete të cilat janë në favor të menaxhimit të karrierës së studentëve. Nga ana tjetër edhe strukturat administrative realizojnë trajnime lidhur me këtë proces.</p> <p><i>Shih:Ev. 2_38_1 Trajnim Profesional mbi Menaxhimin & Këshillimin e Karrierës dhe Team-Building.</i> <i>Shih:Ev. 1_14_Rregullore, e ZMJP&KK. Neni 5 “Kompetencat dhe veprimtaria”</i> <i>Shih: Ev. 2_26_8_Model /template, Pyetësor për gjurmimin e studentëve KUQ (Alumni)</i> <i>Shih: Ev. 2_26_9_Model /template, Pyetësor për Klubet studentore në KUQ</i> <i>Shih: Ev. 2_26_10_Model /template, Pyetësor për bashkëpunëtorë të KUQ.</i> <i>Shih: Ev. 2_30_ Raport për Open Day 2023.</i> <i>Shih:Ev. 2_30_1 Panairi Career Fair 2023, Njihuni me punëdhënësin e ardhshëm dhe mësoni nga ekspertët.</i> <i>Ref: https://qiriazhi.edu.al/career-fair-2023/</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>KUQ siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit. Ky kriter prmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

Standardi I.3


Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>GVJ konstaton se IAL KUQ ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me Statutin e IAL KUQ, Rregulloren e NJSBC, paketa e instrumentave për matjen e cilësisë, Statuti i KUQ etj. Statuti i KUQ dhe një sërë rregulloresh përcaktojnë politikat dhe strukturat për sigurimin e brendshëm të cilësisë gjë kjo që evidentohet si nga dokumentimi i tyre ashtu edhe nga zbatueshmëria.</p> <p><i>Shih: Ev. 1_5_1 Politikat e NSBC.</i> <i>Shih: Ev. 1_5 Rregullore e NJSBC, neni 4.</i> <i>Shih: Ev. 2_26 Paketa e Instrumentave për Matjen e Cilësisë. (paketa e re)</i> <i>Shih: Ev. 2_23 Të dhëna për anëtarët e NJSBC.</i> <i>Shih: Ev. 1_1 Statuti i KU "Qiriazit", neni 15/2 germa "a", nenet 51-52.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>IAL KUQ ka ndjekur një strategji institucionale lidhur me sigurimin e cilësisë në institucion, sigurim cilësie që ka pasur karakter gjithëpërfshirës si nga stafi akademik, ashtu dhe nga studentët, dhe është shoqëruar me kërkesa gjithnjë në rritje ku nga secili punonjës kërkohet maksimumi i performancës dhe kualifikimi i vazhdueshëm. GVJ konstaton që IAL KUQ ka ngritur strukturën për sigurimin e cilësisë, konkretisht Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) nëpërmjet të cilës zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, dhe ka një sistem funksional. NJSBC monitoron cilësinë e mësimdhënies, vlerësimin periodik, ndjekjen dhe zhvillimin e pyetësorit të stafit akademik (si dhe fokus grupet me studentët) dhe studentëve për cilësinë e ofrimit të programeve të studimit, etj. Qëllimi kryesor i NJSBC-së është që nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të politikave dhe procedurave bashkëkohore, si edhe angazhimit të të gjitha niveleve drejtuese dhe organizative të sigurohet rritja e vazhdueshme e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al



	<p>cilësisë së formimit të studentëve, duke u ofruar atyre dijet, metodat dhe teknikat më bashkëkohore të mësimdhënies.</p> <p><i>Shih: Ev. 1_1 Statuti i KU "Qiriazhi", nenet 51-52.</i> <i>Shih: Ev. 1_5 Rregullore e NJSBC, neni 4.</i> <i>Shih: Ev. 1_5_1 Politikat e NSBC.</i> <i>Shih: Ev. 1_6 Manuali i Cilësisë së KU "Qiriazhi".</i> <i>Shih: Ev. 2_25 Raporti vjetor i veprimtarisë së NjsBC për vitin akademik 2022-2023.</i> <i>Shih: Ev. 2_23 Të dhëna për anëtarët e NjsBC.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>GVJ konstaton se IAL KUQ përdor instrumentat e duhura për sigurimin e cilësisë. IAL KUQ përdor metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse (përdor pyetësorë fizikë si dhe fokus grupet me studentët) për sigurimin e cilësisë në institucion si dhe për të ndjekur ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur, teknikave pedagogjike të përdorura nga pedagogët, etj., si dhe për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit, proces i cili organizohet nga NjsBC për secilin nga proceset akademike që kontrollohen gjatë vitit dhe ku rezultatet e tyre i raportohen Rektorit. NjsBC jep rekomandime mbi përmirësimin e hapave që duhen ndjekur për të qenë në koherencë të plotë me zbatimin e kërkesave të MAS si dhe atyre në lidhje me përmbushjen e procedurave që duhet të ndiqen për akreditimin e programeve të studimit. NjsBC bashkëpunon me ASCAL duke marrë pjesë jo vetëm në trajnimet dhe takimet e organizuara prej tyre rreth cilësisë, standardeve dhe proceseve të vlerësimit, por edhe duke organizuar takime me natyrë informuese dhe sqaruese për proceset e vetëvlerësimit, etj. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë kryhet nëpërmjet proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit.</p> <p><i>Shih: Ev. 1_2 Akte nënligjore për KU "Qiriazhi".</i> <i>Shih: Ev. 2_2 Urdhër Nr.384, datë, 08.07.2022, "Për hapjen në KU "Qiriazhi" të Programit të Studimit me Karakter Profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ".</i> <i>Shih: Ev. 1_1 Statuti i KU "Qiriazhi". Neni 52/2.</i> <i>Shih: Ev. 1_5 Rregullore e NJSBC, nenet 2- 3</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe</p>	<p>IAL KUQ përdor tregues të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie e kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, IAL KUQ bën promovime nxitëse për arritjet më</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

<p>kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira.</p>	<p>të mira në programin e studimit, e cila bëhet gjatë mbledhjeve periodike të drejtuesve me stafin dhe studentët me synim që këto shembuj pozitivë të shërbejnë si benchmark edhe për programet e tjera të studimit. KUQ përdor tregues transparent, të qartë dhe të matshmëm për evidentimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, kjo jo vetëm për të promovuar vlerat por edhe për të analizuar të metat dobesitë dhe arritjet.</p> <p><i>Shih: Ev. 1_5_1 Politikat e NSBC</i> <i>Shih: Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC.</i> <i>Shih: Ev. 2_26_Paketa e Instrumentave për Matjen e Cilësisë.</i> <i>Shih: Ev. 1_1_Statuti i Kolegjit Universitar "Qiriazi", nenet 51-52.</i> <i>Shih:Ev. 2_25_Raporti vjetor i veprimtarisë së NJSBC për vitin akademik 2022-2023.</i> <i>Shih:Ev. 1_30_Shkresë përcjellëse e Raportit vjetor i KU "Qiriazi" 2022-2023.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë..</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programet e studimit janë të organizuara në lëndë dhe module, të vlerësuara me kredite, në përputhje me Udhëzimin 31 të MASR, si dhe VKM nr.41 me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Programi zhvillohet në 2 vite akademike, me mundësi transferimi kreditesh sipas standardeve Evropiane. Programi mësimor është i organizuar në 120 kredite të ndara në dy vite akademike, sipas dy semestrave në çdo vit, me ngarkesë prej 60 kreditesh në çdo vit. Ndarja e krediteve sipas kategorive është: Kategoria A e organizuar sipas 15 krediteve, kategoria B e organizuar sipas 71 krediteve, kategoria C e organizuar sipas 12 krediteve, kategoria D e organizuar sipas 18 krediteve, kategoria E e organizuar sipas 4 krediteve. <i>Sugjerohet rregullimi i kategorisë B në limitin e 66 krediteve.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 3_1_Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ" nenet 11-16.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 3_3_Plani Mësimorë.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 3_4_Veprimtaria formuese e programit.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 3_11_Modeli Diplomë Profesionale "Asistent Ligjor dhe Administrativ"</i></p> <p><i>Ref: Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, "Niveli 5".</i></p> <p><i>Ref: VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë". (Ndryshuar).</i></p> <p><i>Ref: Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Neni 72.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës,</p>	<p>Programi i studimit në formimin e kurrikulave, në shtrimin e objektivave si dhe me strukturën akademike si dhe procedurat ndërmjet të cilave operon, i shërben formimit të studentëve duke ju përgjigjur jo vetëm fushës dhe lëmit administrativ dhe ligjor. Kompetecat profesionale dhe akademike janë të mundësuar jo vetëm nga përmbajtja e programit të studimit por edhe nga forma dhe metodologjia me të cilën ai ofrohet duke ju referuar organizimit të orës mësimore, detyrave individuale apo në grup, praktikë profesionale, realizueshmërisë së tezës së diplomës etj. Këto elementë të ofrimit të programit të studimit janë të përcaktuar edhe në rregulloren e programit të studimit. Duke ju referuar përbërjes së kurrikulave sipas disiplinave përkatëse si edhe syllabuseve të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

<p>zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale.</p>	<p>lëndëve rekomandohet që të përshtaten më mirë me ciklin në të cilin oferohen ashtu si edhe me profilin përkatës. <i>Gjithashtu për shkak të nivelit profesional të programit do të sugjeroja përfshirjen e praktikës profesionale edhe si pjesë e programit të lëndës, nga ana tjetër ndërthurja e programeve të lëndëve me njëra tjetrën si dhe integrimi i tyre me aspektin teknologjik apo me aplikimin kompjuterik të tyre do të ishte domosdoshmeri në ato lëndë ku kjo është e mundur.</i></p> <p><i>Shih: Ev. _3_1_ Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ”, nenet 6; 16 dhe 17.</i></p> <p><i>Shih: Ev. _3_3_ Plani Mësimorë</i></p> <p><i>Shih: Ev. _3_4_ Veprimtaria formuese e programit</i></p> <p><i>Shih: Ev. _3_8_ Programet mësimore (syllabuset)</i></p> <p><i>Shih: Ev. _2_14_ Plani Strategjik.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ” ka objektiva të qarta lidhur pikërisht me kompetencat profesionale, aftësitë dijet që duhet të ketë studenti në përfundim të këtij programi. Konstatohet nga GVJ që në disa raste këto objektiva të programit të studimit zbehen në raport me objektivat e programeve lëndore. Siç është shprehur edhe më parë në disa raste tejkalohet niveli profesional që duhet të ketë lënda duke e bërë atë më të përshtatshme për ciklin e parë të studimeve bachelor.</p> <p><i>Shih: Ev. _3_1_ Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ”, neni 17.</i></p> <p><i>Shih: Ev. _2_14_ Plani Strategjik.</i></p> <p><i>Shih: Ev. _3_3_ Plani Mësimorë.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblyëse.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ” reflekton në planin mësimor ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet. Programi është i organizuar në 2 vite akademike, 4 semestra dhe me 120 ECTS referuar nivelit 5 të KSHK-së. Praktika profesionale është vlerësuar me 7 ECTS, provimi përfundimtar është i vlerësuar me 4 ECTS.</p> <p><i>Shih: Ev. _3-1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ”. neni 12.</i></p> <p><i>Shih: Nën/Dosja (3) Aneksi 3 Dosja e plotë Didaktike</i></p> <p><i>Shih: Ev. _3-9 Udhëzues i Praktikave.</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadër ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional Asistent Ligjor dhe Administrativ ka të përcaktuar formën e organizimit të studimeve, që nga momenti i pranimit të studentëve. Forma e studimeve është me kohë të plotë dhe për kategori të ndryshme studentësh ofrohen bursa. Pranimi i studentëve në këtë program studimi bëhet në përputhje me përcaktimet ligjore lidhur me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore.</p> <p><i>Shih: Ev. 1_28_Kriteret e pranimit të studentëve në KU "Qiriazi", për vitin akademik 2023-2024.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 1_25_Vendimi i Bordit Administrativ për tarifa dhe bursa.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 3-1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ". neni 15.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 1_23_Kontrata me të tretët.</i></p> <p><i>Ref: https://qiriazi.edu.al/kriteret-e-pranimit-2/</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional Asistent Ligjor dhe Administrativ ofrohet në përputhje me kriterin e ngjashmërisë në nivel së paku 70% në përmbajtje me programet analoge me të njëjtën emërtësë në IAL të tjera. Pra një program i tillë Asistent Ligjor dhe Administrativ ofrohet edhe nga IAL të tjera, dhe programet ndërmejt tyre kanë tyre kanë t paktën 70% ngjashmëri në kurrikul, plane mësimore, përmbajtje etj.</p> <p><i>shih: Ev. 3_4_Veprimtaria formuese e programit.</i></p> <p><i>Ref: Udhëzim Nr.31, datë 15.11.2022 "Për procedurat për Kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"</i></p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ" është kodifikuar duke u bazuar tek kërkesat e MAS.</p> <p>Kodi i programit: 52PP0488S</p> <p><i>Shih: Ev. 2_16_ Të dhëna për kodifikimin e programeve të studimit në FD.</i></p> <p><i>Ref: Udhëzim Nr.31, datë 15.11.2022 "Për procedurat për Kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"</i></p> <p><i>https://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2022/11/Udhezim-Nr.31-date-15.11.2022-Kodifikimi-i-programeve-te-studimit-IAL-pdf.pdf</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

Konkluzione	<i>Programi i studimit me karakter profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ" organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore. Ky kriter përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Departamenti i të Drejtës Civile dhe Tregëtare të Fakultetit të Drejtësisë realizon kriteret ligjore për administrimin e programit të studimit me karakter profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ". Aktualisht Fakulteti i Drejtësisë 2023-2024 ka personel akademik PAE 21 dhe PAK 3, ndërsa Departamenti ka 5 PAE nga të cilët 3 Dr dhe 2 Msc. Ky departament/fakultet në zbatim të bazës ligjore ka krijuar instrumentat e duhur akademik për realizimin e programit të studimit me karakter profesional në "Asistent Ligjor dhe Administrativ" sipas përcaktimeve përkatëse mbi bazën e të cilave është hapur si program. Personeli akademik në funksion të programit është sipas kërkesave të përcaktuara.</p> <p><i>Shih: Ev. 2_3_Vendim i Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë, Nr.157 Prot, datë 21/11/2023 "Për ngritjen e GVB, për akreditimin e programit të studimit me Karakter Profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ".</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_5_Rregullore e FD.</i></p> <p><i>Shih: Ev 2_15_1 Marrëveshje MAS-KU "Qiriazhi", "Për përcaktimin e numrit të anëtarëve të personelit akademik"</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_7_Rregullore DDCT, neni 4.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_9_Analiza vjetore e DDCT.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_27_2 Informacion tabelor mbi numrin e personelit akademik për çdo njësi bazë: (PAE) dhe (PAK), titujt/gradat.</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

	<p><i>Shih: Ev. 2_27_3 Informacion tabelor mbi Planin mësimor lidhur me personelin akademik përkatës për programin e studimit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Njësia kryesore ka kapacitete njerëzore të cilat i angazhon në relizimin e procesve mësimore si dhe disiplinave respektive të Programit të studimit me karakter profesional Asistent Ligjor dhe Administrativ. DDCT ka përbërje me 7 personel akademik nga të cilët 4 Dr dhe 3 MSc. Ndërkohë sa i përket programit të studimit përbërja e personelit akademik është 12 personel akademik PAE 2 Prof. Asoc. Dr., 6 Dr., dhe 2 MSc.</p> <p><i>Shih: Ev. 2_9 Analiza vjetore e DDCT.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_17_ Të dhëna Tabelore mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve të programit.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_35_2 Relacion mbi ecurinë e veprimtarive kërkimore shkencore 2019-2023.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_27_2 Informacion tabelor mbi numrin e personelit akademik për çdo njësi bazë: (PAE) dhe (PAK), titujt/gradat.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_27_3 Informacion tabelor mbi Planin mësimor lidhur me personelin akademik përkatës për programin e studimit.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_27 Informacion tabelor mbi Ngarkesa totale e personelit akademik të programit.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_27_1 Informacion tabelor mbi cilësinë e stafit mësimdhënës sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre për programin e studimit ; Të dhëna sipas moshës; Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre.</i></p> <p><i>SShih: Ev. 2_26_6 Model /template, Formular të kërkimit shkencor;</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_28 CV e stafit akademik të programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin</p>	<p>Për Programin e studimit me karakter profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ” në përputhje me rregulloren e Fakultetit të Drejtësisë dhe Departamentin e të Drejtës Civile dhe Tregëtare ka përcaktuar koordinatorin e programit të studimit. Koordinatori i programit të studimit është përgjegjës për administrimin e të gjithë procesit të studimeve , si dhe shqyrton kërkesat e studentëve si dhe raporton për respektimin e standardeve të cilësisë.</p> <p><i>Shih: Ev. 2_15_ Vendimi për caktimin e Koordinatorit të programit të studimit.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 3-1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ”, neni 9/1</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	<i>Shih: Ev. 2_9_ Analiza vjetore e DDCT.</i>			
Konkluzione	<i>Njësia kryesore Fakulteti i Drejtësisë dhe njësia bazë përgjegjëse Departamenti i të Drejtës Civile dhe Tregëtare për Programin e studimit me karakter profesional në "Asistent Ligjor dhe Administrativ" përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Dokumentacioni për strukturën, organizimin dhe përmbajtjen e Programit të studimit me karakter profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ", administrohet nga Departamenti i të Drejtës Civile dhe Tregëtare si njësi bazë kërkimore shkencore e Fakultetit të Drejtësisë. Njësia bazë dhe njësia kryesore disponojnë kurrikulat, planet mësimore, rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e njësive ndërmjet të cilave administrohet programi i studimit. <i>Shih: Ev. 2_7_ Rregullore DDCT, nenet 5 dhe 17.</i> <i>Shih: Ev. 3-1 Rregullore e programit të studimit, neni 4.</i> <i>Shih: Nën/Dosja (3) Dosja e plotë Didaktike.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në	Plani mësimor i Programit të studimit me karakter profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ" pasqyron informacionin në lidhje me shpërndarjen e lëndëve dhe moduleve në semestra, ngarkesën mësimore në auditor, orët jashtë auditorit/studimit individual të studentit. Rekomandohet që plani mësimor dhe kurrikula të pasqyrojnë klasifikimin në lëndë të detyrueshme dhe lëndë me zgjedhje, kjo ndarje mungon. Rekomandohet gjithashtu që lektorët me kohë të pjesshme të vijnë nga praktika për shkak të

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gimn. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

<p>kredite, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>karakterit profesional të programit të studimit. Gjithashtu rekomandohet që lëndët duhen përshtatur patjetër me nivelin profesional. Ngarkesa mësimore e stafit PAE për programin e studimit ALA është si vijon Dr. V.Memini 150 orë në ALA, Dr. N. ALIBALI 150 orë në ALA, Dr. A. Kulli 75 orë në ALA, Dr. L. Kiri 200 orë në ALA, Dr. M. Kraja 75 orë ALA, Prof. Asoc. Dr. GJ. Uldedaj 60 orë ALA, Msc S. Çollaku 60 orë ALA, Prof. Dr. H. Xhafa 60 orë ALA, M. Resulaj 75 ore ALA, Prof. Asoc. Dr. E. Boxheku 80 orë ALA, O. Frani 75 orë, M. Muja 75 orë ALA.</p> <p><i>Shih: Ev. 3 -3_ Plani Mësimor</i> <i>Shih: Ev. 3 -4_ Veprimtaria formuese e programit</i> <i>Shih: Ev. 3_8_ Programet mësimore (syllabuset)</i> <i>Shih: Ev. 2_18_ Ngarkesa totale në auditor e studentëve për Format e mësimdhënies si dhe Format e kontrollit të njohurive në programin e studimit "Asistent Ligjor dhe Administrativ".</i> <i>Shih: Ev. 3_1_ Rregullore e programit të studimit</i> <i>Shih: Ev. 2_21_ Model /template, Teze Kolokiumi.</i> <i>Shih: Ev. 2_21_1 Model /template Teze provimi përfundimtar.</i> <i>Shih: Ev. 2_26_ 5 Model /template, Formular i vlerësimit të studentit praktikant;</i> <i>Shih: Ev. 2_22_ Print screen,faqe "Moodle</i> <i>Shih: Ev. 1_36_ Faqja zyrtare e internetit ëëë.qiriazhi.edu.al</i> <i>Shih:Ev. 2_38_ Katalogu i KUQ.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me kriteret e pranimit, transferimit e ekuivalentimit të studimeve. Kriteret për pranimin e studentëve që ndjek KUQ për këtë program studimi janë të pasqyruara në Rregulloren përkatëse të KUQ dhe të Departamentit të së Drejtës Civile dhe Tregëtare, po ashtu edhe procesi i ekuivalentimit nga IAL të tjera drejt KUQ dhe anasjelltas.</p> <p><i>Shih: Ev. 1_4_ Rregullore e KU "Qiriazhi", nenet 67-68.</i> <i>Shih: Ev. 1_28_ Kriteret e pranimit të studentëve në KU "Qiriazhi", për vitin akademik 2023-2024.</i> <i>Shih:Ev. 1_29_ Programi i punës për regjistrimet dhe komisionet e vecanta, 2022-2023.</i> <i>Shih: Ev.2_12_1 Rregullore e transferimeve.</i> <i>Shih:Ev.2_12_2 Shembull Dosja e Dokumenteve të studentit për transferimet e studimeve.</i> https://qiriazhi.edu.al/transferimi-i-studimeve/</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gimn. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programet e lëndëve janë subjekt rishikimi me qëllim përditësimin e tyre. Në program gjendet informacioni në lidhje me objektivat e lëndës, temat e lëndës, format e kontrollit të dijeve dhe mënyra e vlerësimit. Në fillim të çdo viti plotësohet për Programet e studimit me karakter profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ” dosja e cila përmban kurrikulën, planet mësimore, ngarkesën e stafit akademik, syllabuset etj.</p> <p><i>Shih: Nën/Dosja (3) Aneksi 3 Dosja e plotë Didaktike.</i> <i>Shih: Ev.3-9 Udhëzues i Praktikave,</i> <i>Shih: Ev.3-10 Udhëzues Didaktik</i> <i>Ref. VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë” (ndryshuar VKM 185, datë 25/03/2021).</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ” përditësohet periodikisht në fillim të çdo viti duke ju përshtatur ndryshimeve që vijnë si propozime të njëjësive si dhe duke ju përshtatur ndryshimeve të tregut. Syllabuset ndërtohen në mënyrë të tillë që të shmangin përsëritjet dhe mbivendosjet. Ndryshimet në planin mësimor të programit të studimit miratohen me vendim senati.</p> <p>Dosja e plotë didaktike</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese për një program dyvjeçar me karakter profesional. Informacionet mbi programin e studimit i vendosen në dispozicion studentëve përmes syllabuseve të lëndëve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.</p>	<p>Përmbajta e programeve të studimit, shpërndarja e lëndëve dhe shembujt praktikë të trajtuar gjatë të gjithë ciklit të studimit, mundësojnë për studentët e KUQ, pjesë e Fakultetit të Drejtësisë, thellim të njohurive dhe aftësive të tyre në lidhje me kërkesat e tregut të punës. Programi i studimit me karakter profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ” duke zhvilluar aftësi teknike, ndërpersonale dhe konceptuale, mundëson punësimin e të diplomuarve në mënyrë të veçantë edhe në përputhje me kuadrin ligjor, në përfundim lëshohet “Diplomë Profesionale” në përputhje me parashikimet e nenit 72 të Ligjit nr Nr 80/15.</p> <p><i>Shih: Nën/Dosja (3) Aneksi 3 Dosja e plotë Didaktike.</i> <i>Shih:Ev. 3-1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ”, neni 4 dhe 11 deri 19.</i> <i>Shih: Ev. 2_13 Studimi i Tregut.</i> <i>Ref. VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë” (ndryshuar VKM 185, datë 25/03/2021).</i> <i>Ref. Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 72.</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet.</p>	<p>Plani mësimor i Programit të studimit me karakter profesional Asistent Ligjor dhe Administrativ, është hartuar në bazë të Kuadrit Kombëtar dhe European të studimeve, është organizuar të ketë shtrirje përgjatë 4 semestrave me kohëzgjatje normale 15 javë. Njërtimi i kurrikulave harmonizon disiplinat me objektivat formuese në funksion të aftësive profesionale të studentëve. Përqindjet sipas kategorisë së lëndëve janë: Lëndë Bazë 12.5%, Lëndë Karakterizuese 54.1%, Lëndë ndëdisiplinore/ integruese 15%, Lëndë plotësuese 15%, Detyrime përmbyllëse 3.3%.</p> <p><i>Shih: Ev. 3_1 Rregullore e programit të studimit, neni 12/2.</i> <i>Shih: Ev. 3_3 Plani Mësimorë</i> <i>Shih: Ev. 3_4 Veprimtaria formuese e programit</i> <i>Ref. VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë” (ndryshuar VKM 185, datë 25/03/2021).</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimit në praktikë/punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Në strukturën e programit të studimit evidentohen objektivat formuese të studimit të cilat janë në përputhje me përcaktimet ligjore. Lëndët që ky program studimi përmban janë në përputhje me drejtimin dhe profilin e studimit. Ngarkesa mësimore për këtë program studimi është 3000 orë mësimore me një total (120 ECTS), duke e përafëruar këtë program studimi me programe të ngjashme ndërkombëtare. Kurrikulat sigurojnë mobilitet i cili reflektohet në bashkëpunimin në kuadër të Erasmus +. Praktika profesionale është lëndë e vitit të dytë dhe në përmbushje të saj realizohen orë në institucion dhe 20 orë në konsultime në auditor. Rekomandohet të shtohen orët e praktikës si komponent i programit lëndor.</p> <p><i>Dosja didaktike</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Kurrikula e Programit të studimit me karakter profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ” garanton pajisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme teorike dhe praktike në lidhje me metodat, teknikat dhe instrumentat që u vijnë në ndihmë për të arritur objektivat e synuara të programit të studimit. Veprimtaritë formuese në këtë program studimi mundësojnë transferimin e studimeve, mobilitetet dhe punësimin në përfundim të studimeve. Nërtimi i kurrikulave harmonizon disiplinat me objektivat formuese në funksion të aftësive profesionale të studentëve. Përqindjet sipas kategorisë së lëndëve janë: Lëndë Bazë 12.5%, Lëndë Karakterizuese 54.1%, Lëndë ndëdisiplinore/ integruese 15%, Lëndë plotësuese 15%, Detyrime përmbyllëse 3.3%.</p> <p><i>Shih: Nën/Dosja (3) Aneksi 3 Dosja e plotë Didaktike</i> <i>Shih: Ev. 3_1_Rregullore e programit të studimit, neni 17.</i> <i>Shih: Ev. 2_14_Plani Strategjik</i> <i>Shih: Ev. 2_17_Të dhëna Tabelore mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve të programit.</i> <i>Shih: Ev. 3_3_Plani Mësimorë</i> <i>Shih: Ev. 3_4_Veprimtaria formuese e programit</i> Ref. VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë” (ndryshuar VKM 185, datë 25/03/2021). Ref. https://qiriazhi.edu.al/asistent-ligjor-dhe-administrativ/</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.</p>	<p>Fakulteti i Drejtësisë/Departamenti i së Drejtës Civile dhe Tregëtare, personeli akademik i tij përmirëson vazhdimisht syllabuset. Syllabuset përgatiten duke respektuar formatin tip dhe lirinë akademike. Syllabuset janë të përditësuar në mënyrë të vazhdueshme më qëllim që studentët të përvetësojnë njohuritë e nevojshme nga secila lëndë e zhvilluar në këtë program studimi, në përshtatje me tregun e punës.</p> <p><i>Shih: Nën/Dosja (3) Aneksi 3 Dosja e plotë Didaktike</i> <i>Shih: Ev. 2_25_ Raporti vjetor i veprimtarisë së NJSBC për vitin akademik 2022-2023.</i> <i>Ref: VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë" (ndryshuar).</i></p>
<p>Kriteri 6. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>Në përputhje me objektivat për programe studimi të ciklit të dytë, Programit të studimit me karakter profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ" synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara shkencore teorike e praktike. Ky program studimi i cili ka synim që të përgatisë asistent profesionist administrativ dhe ligjorë, është i hartuar në mënyrë të tillë që i krijon mundësi studentëve të regjistruar të përfitojnë dijet, aftësitë dhe kompetencat e thelluara të nevojshme për të hyrë në tregun e punës. Tutorazhi i praktikës realizohet nga lektorët përgjegjës për praktikën profesionale.</p> <p><i>Shih: Ev. 1_34_ Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit brenda dhe jashtë vendit.</i> <i>Shih: Ev. 2_26_5_</i> <i>Shih: Ev. 3_9_ Udhëzues i Praktikave.</i> <i>Shih: Ev. 3_6_ Model i dosjes së praktikës.</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.</p>	<p>Departamenti i së Drejtës Civile dhe Tregëtare, ka mundur që përmes përmbajtjes së <i>Model /template, Formular i vlerësimit të studentit praktikant</i>. Përmbajtja e programit të studimit i mundëson studentit integrimin e programeve të studimit në mënyrë që të kenë mundësi të vijimësisë së studimeve sipas hapsirave ligjore. Nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara me partnerët, nxitet dhe mundësohet punësimi i tyre duke iu përshtatur nevojave të tregut si dhe mundëson integrimin e dijeve të praktikës me teorinë. Niveli i punësimit ë këtij programi tregon se ai është në përputhje me kërkesat e tregut, si</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

	<p>dhe përmbajtja e tij dëshmon për plotësimin e dijeve të studentëve.</p> <p><i>Shih: Ev. 3_1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ". neni 16-17.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 3_3 Plani Mësimorë</i></p> <p><i>Shih: Ev. 3_8 Programet mësimore (syllabuset)</i></p> <p><i>Shih: Ev. 3_7 Organizimi i një vizite mësimore në kuadër të lëndës.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_13 Studimi i Tregut: "Mbi hapjen e programit të studimeve"</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Struktura dhe organizimi i programit të studimit me karakter profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ" është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Rezultatet e të nxënit , kompetencat e fituara janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës..</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh</p>	<p>Për përshtatjen e mirë të programit të studimit me karakter profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ" me kërkesat e tregut të punës, strukturat përgjegjëse të KUQ marrin në konsideratë propozimeve dhe informacionit që i vjen nga studimi i tregut. Ecuria e programeve të studimit ndiqet nga departamenti dhe fakulteti duke përfshirë edhe mendimin e përfaqësuesve të tregut të punës si dhe feedback-un nga studentët. Gjatë takimeve me institucione partnere diskutohet lidhur me nevojat e tregut të punës dhe njëkohësisht organizohen dhe aktivitete si Panairi i Punës CAREEF FAIR 2023 si një moment që shërben edhe për studentët edhe për partnerët.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

<p>propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p><i>Shih: Ev. 1_34_Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit brenda dhe jashtë vendit</i> <i>Shih: Ev. 2_9_Analiza vjetore e DDCT.</i> <i>Shih: Ev. 2_13_ Studimi i Tregut</i> <i>Shih: Ev. 2_37_ Raport- Plan-Pune ZMJP&KK</i> <i>Shih: Ev.2_37_2Udhëzues Marrëdhënia me Partnerët & Biznesin, ZMJP&KK.</i> <i>Shih: Ev. 2_30_ Raport për Open Day 2023</i> <i>Shih: Ev. 2_30_1 Panairi Career Fair 2023, Njihuni me punëdhënësin e ardhshëm dhe mësoni nga ekspertët.</i> <i>Ref: https://qiriaz.edu.al/career-fair-2023/</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>KUQ përfshin studentët në vendimarrjen dhe në çështje madhore të institucionit. Studentët janë pjesë e organeve vendimarrëse dhe kolegjinale të KUQ, si Senati Akademik si dhe janë pjesë aktive e diskutimeve. Mbahen lidhje me studentët e diplomuar. Feedback-u dhe informacioni që vjen nga studentët pjesë e ALUMNI si dhe partnerët me të cilët KUQ ka marrëveshje bashkëpunimi ku studentët realizojnë edhe praktikën profesionale, është një burim nga i cili KUQ realizon përmirësim në programet e studimit dhe kurrikulat.</p> <p><i>Shih: Ev. 2_32_ Aktivizimi i studentëve në mbledhje të njësisë</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale dhe institucione publike e private.</p>	<p>Departamenti i së Drejtës Civile dhe Tregëtare në bashkëpunim me partnerët realizon përmirësime në programin e studimit dhe në syllabuset respektive. Departamentit vjell ide dhe nevoja konkrete nga ana e këtyre institucioneve në mënyrë që të përshtatë programet studimore sa më shumë të jetë e mundur me nevojat konkrete të administratës publike, në nivel qendror dhe nivel lokal. Eksperiancat me universitetet perendimore japin një kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e programit dhe në sigurimin e mobilitetit të tij.</p> <p><i>Shih: Ev. 1_34_Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit brenda dhe jashtë vendit.</i> <i>Shih: Ev. 3_8_17 Praktikë profesionale</i> <i>Shih: Ev. 3_9_ Udhëzues i Praktikave,</i> <i>Shih: Ev.2_36_ Informacion tabelor mbi Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi studimi për</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

	<i>Praktikat profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë</i>			
Konkluzione	<i>KUQ nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit me karakter profesional Asistent Ligjor dhe Administrativ dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre. Departamenti is ë Drejtës Civile dhe Tregëtare përmirëson dhe përditëson programin e studimit..</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo	KUQ përdor metoda bashkëkohore të mësimdhënies. Aktualisht për programin e studimit me karakter profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ” integrohen dy metoda të mesimdhënies: aspekti teorik ku përfshihen leksionet dhe aspekti praktik ku përfshihen seminarët detyrat e kursit etj. Nga KUQ motivohet puna në menyrë të pavarur e studentit. Në syllabus evidentohen format e miratuara të mësimdhënies nga KUQ. <i>Shih: Nën/Dosja (3) Aneksi 3 Dosja e plotë Didaktike: Shih: Ev. 3_8 Programet mësimore (syllabuset) Shih: Ev. 3_1 Rregullore e programit të studimit, neni 12.</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

<p>formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p><i>Shih: Ev. 1_23_1 Të dhëna për Platformen Moodle.</i> <i>Shih: Ev. 3_9 Udhëzues i Praktikave,</i> <i>Shih: Ev. 3_10 Udhëzues Didaktik</i> <i>Shih: Ev. 1_19 Udhëzues për përdorimin e platformave on-line të mësimdhënies.</i> <i>Shih: Ev. 2_33 Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Realizimi i programit të studimit me karakter profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ” ka në dispozicion të gjithë infrastrukturën e nevojshme për realizuar në mënyrë të suksesshme mësimdhënien. Mjediset në të cilat zhvillohet mësimi janë të pajisura me mjetet e duhura për zhvillimin normal të mësimi. Personeli akademik sipas rastit përdor mjete alternative për të realizuar një mësimdhënie sa më efikase dhe në funksion të objektiva të programit të studimit. Një shembull i mirë është edhe përshtatja e menjëhershme e KUQ me situatën e mësimdhënies online gjatë pandemisë.</p> <p><i>Shih: Nën/Dosja (3) Aneksi 3 Dosja e plotë Didaktike.</i> <i>Shih: Ev. 2_14 Plani Strategjik i programit.</i> <i>Shih: Ev. 1_23_1 Të dhëna për Platformen Moodle</i> <i>Shih: Ev. 1_24 Infrastruktura mësimore e KU “Qiriazhi”.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>KUQ mundëson përmirësimin e formimit të personelit akademik duke ju ofruar mundësi trajnimi dhe kualifikimi brenda institucionit por edhe nga institucione të tjera. Nga KUQ realizohen gjithashtu seanca trajnimi periodike mes personelit akademik dhe studentëve në funksion të efikasitetit të procesit të mësimdhënies. Disa nga ttrajnimet: Trajnimin dhe Zhvillimin Profesional, Trajnimeve për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të Stafit Akademik, Trajnim Profesional mbi Menaxhimin & Këshillimin e Karrierës dhe Team-Building.</p> <p><i>Shih: Ev. 1_13_5 Plani Strategjik: Mbi Trajnimin dhe Zhvillimin Profesional.</i> <i>Shih: Ev. 2_28_2 Trajnim stafi Akademik: Seria e Trajnimeve për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të Stafit Akademik.</i> <i>Shih: Ev. 1_34 Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit brenda dhe jashtë vendit.</i> <i>Shih: Ev. 1_34_1 Shembull: Erasmus+</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

	<i>Shih: Ev. 2_38_1 Trajnim Profesional mbi Menaxhimin & Këshillimin e Karrierës dhe Team-Building.</i>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik te student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>KUQ në politikat e tij të përzgjedhjes së personelit akademik promovon përfshirjen e lektorëve me titujt dhe gradat respektive për tu përfshirë në mësimdhënie në programin e studimit me karakter profesional Asistent Ligjor dhe Administrativ. Gjithashtu KUQ përpiket të bëjë pjesë të insitucionit brezin e specialistëve të shkolluar në vendet perëndimore duke i dhënë një mundësi më shumë eksperiencave bashkëkohore të mësimdhënies të bëhen pjesë e institucionit dhe e praktikave që ai përdor dhe adapton për të administruar procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Suksesi i këtyre procesve reflektohet edhe në vlerësimet e studentëve si pjesë e vlerësimit të mësimdhënies. Sipas rastit KUQ realizon trajnime kur është e nevojshme për të ndihmuar në këtë proces si dhe për të ndihmuar në adaptimin e teknikave inovative. Metodatat e mesimdhënies dhe të kontrollit të dijeve janë të pasqyruara në syllabuset repektive të miratura nga departamenti përkatës.</p> <p><i>Shih: Ev. 1_34 Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit brenda dhe jashtë vendit.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 1_34_1, Erasmus+</i></p> <p><i>Shih: Ev. 3_1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ"</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_9 Analiza vjetore e DDCT.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_26_1 Model /template, Pyetësori i studentit</i></p> <p><i>Shih: Ev. 3_3_3 Plani Mësimorë</i></p> <p><i>Shih: Ev. 3_5 Personeli Akademik</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_37_1 Të dhëna mbi aktivitetet për kërkimin shkencor dhe kualifikimin 2020-2023.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_28 CV e stafit akademik të programit të studimit</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_27_3 Informacion tabelor mbi Planin mësimor lidhur me personelin akademik përkatës për programin e studimit.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_10_1 Veprimtaritë, aktivitete të QKSH të FD.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë</p>	<p>Departamenti i së Drejtës Civile dhe Tregëtare si pjesë integrale e Fakultetit të Drejtësisë administron programin e studimit me karakter profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ" në drejtim të veprimtarisë akademike, këkimore shkencore dhe administrative. Njësia kryesore dhe njësia bazë janë përgjegjëse për menaxhimin e cilësisë së programit të studimit. Drejtuesi i</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

<p>periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>njesisë kryesore kontrollon cilësinë e procesit mësimor. Bazuar në feedbackun e marrë nga instrumenta të kontrollit dhe menaxhimit të cilësisë relazohet edhe procesi i përmirësimit të performancës.</p> <p><i>Shih: Nën/Dosja (3) Aneksi 3- Dosja e plotë Didaktike.</i> <i>Shih: Ev. 1_18_ Metodatat e mësimdhënies dhe Didaktika në Distançë</i> <i>Shih: Ev. 2_25_ Raporti vjetor i veprimtarisë së NJSBC për vitin akademik 2022-2023.</i> <i>Shih: Ev. 2_26_ Paketa e Instrumentave për Matjen e Cilësisë.</i> <i>Shih: Ev. 2_32_ Aktivizimi i studentëve në mbledhje të njesisë, dhe Kërkesa Kryetarit të Këshillit Studentor.</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimin të metodave të reja.</p>	<p>KUQ mundëson përmirësimin e formimit të personelit akademik duke ju ofruar mundësi trajnimi dhe kualifikimi brenda institucionit por edhe nga institucione të tjera. Nga KUQ realizohen gjithashtu seanca trajnimi periodike mes personelit akademik dhe studentëve në funksion të efikasitetit të procesit të mësimdhënies. KUQ gjithashtu ka institucionalizuar Komisionet e përherëshme. NJSBC, Njësia bazë dhe Njësia Kryesore janë struktura të cialt merrën direkt me menaxhimin e këtij procesi duke u bazuar në Udhëzuesin për kualifikimin e stafit, Manualin e cilësisë, Regulloren e NJSBC etj.</p> <p><i>Shih: Ev. 1_17_ Udhëzues për kualifikimin e stafit akademik të KU "Qiriazi".</i> <i>Shih: Ev. 1_13_5_ Plani Strategjik: Mbi Trajnimin dhe Zhvillimin Profesional.</i> <i>Shih: Ev. 2_28_2_ Trajnim stafi Akademik: Seria e Trajnimeve për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të Stafit Akademik.</i> <i>Shih: Ev. 1_18_ Metodatat e mësimdhënies dhe Didaktika në Distançë</i> <i>Shih: Ev. 1_19_ Udhëzues për përdorimin e platformave on-line të mësimdhënies.</i> <i>Shih: Ev. 1_5_ Rregullore e NJSBC.</i> <i>Shih: Ev. 1_5_1 Politikatat e NJSBC</i> <i>Shih: Ev. 1_6_ Manuali i Cilësisë së Kolegjit Universitar "Qiriazi"</i> <i>Shih: Ev. 1_7_ Politikatat e vlerësimit të brendshëm..</i> <i>Shih: Ev. 1_15_ Strategjia për Kërkimin Shkencor, Projektet, Partneritetin 2023-2028</i> <i>Shih: Ev. 1_16_ Kriteret për alokimin e fondit vjetor të</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

	<p><i>Shih: Ev. 1_16_1_Formulari i Kërkimit Shkencor</i> <i>Shih: Ev. 1_5_2 Raporti Vjetor i NjsBC.</i> <i>Shih: Ev. 2_9_Analiza vjetore e DDCT.</i> <i>Shih: Ev. 1_30_Shkresë përcjellëse e Raportit vjetor i KU "Qirazi" 2022-2023.</i> <i>Shih: Ev. 1_27_Miratim i fondit, për punën shkencore viti akademik, 2022-2023 dhe 2023-2024</i> <i>Shih: Ev. 2_27_2_Informacion tabelor mbi numrin e personelit akademik për çdo njësi bazë: (PAE) dhe (PAK), titujt/gradat.</i> <i>Shih: Ev. 2_27_3_Informacion tabelor mbi Planin mësimor lidhur me personelin akademik përkatës për programin e studimit.</i> <i>Shih: Ev. 2_28_CV e stafit akademik të programit të studimit.</i></p>			
Konkluzione	<p><i>KUQ garanton procesin e të nxëniet dhe aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. Personeli akademik i përgjigjet larmishmërisë së studentëve duke përdorur metoda të ndryshme mësimdhënieje.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Mënyrat e kontrollit të dijeve dhe testimit të njohurive dhe aftësive profesionale për programin e studimit me karakter profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ" janë të pëcaktuara qartë në Rregulloren e Njësisë bazë dhe asaj kryesore ashtu siç edhe në rregulloren e programit të studimit. Pëveç formave klasike në këtë program studimi vlerësohet edhe aktivizimi, detyrat e kursit, projektet, testimet etj.</p> <p><i>Shih: Ev. 1_4_Rregullore e KU "Qirazi" Kreu IX, Vlerësimi i dijeve.</i> <i>Shih: Ev. 3_1_Rregullore e programit të studimit. neni 22.</i> <i>Shih: Ev. 1_12_Rregullore e sekretarisë mësimore. Neni 5.</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

	<p><i>Shih: Ev. 2_26_7_Model /template, Formular i vlerësimit të vazhdueshëm të studentit</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_26_5_Model /template, Formular i vlerësimit të studentit praktikant.</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ” në programet e lëndëve dhe disiplinave respektive përcakton qartë mënyrat e vlerësimit si planin mësimor të çdo lënde. Ky informacion i bëhet i ditur studentit që në orën e parë të lëndës përkatëse nga personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien e asaj lënde, shpërndarja e këtij informacioni realizohet edhe nga pedagogu tutor. Programet e lëndëve janë të publikuara edhe në portalin e KUQ në sitin personal të pedagogëve. Pra, studentëve u prezantohet struktura e lëndëve dhe përqindjet e pikëve për të gjithë elementët.</p> <p><i>Shih: Ev. 3_10_Udhëzues Didaktik</i></p> <p><i>Shih: Ev. 3_1_Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_21_Model /template, Teze Kolokiumi.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_21_1 Model /template Teze provimi përfundimtar.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_26_7_Model /template, Formular i vlerësimit të vazhdueshëm të studentit</i></p> <p><i>Shih: Ev. 2_26_5_Model /template, Formular i vlerësimit të studentit praktikant.</i></p> <p><i>Shih: Ev. 3_8_Programet mësimore (syllabuset)</i></p> <p>Ref. VKM Nr. 41, date 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, (ndryshuar).</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike.</p>	<p>Studentët në programin e studimit me karakter profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ” vlerësohen ndërmjet provimeve të ndërmjetme, detyrave të kursit, projekteve, rasteve të studimit dhe provimit përfundimtar. Siç u shprehëm më lart mënyra e vlerësimit është e shprehur në syllabusin e lëndës dhe u bëhet e ditur studentëve.</p> <p><i>Shih: Ev. 1_4_Rregullore e KU “Qiriazit” Kreu IX, Vlerësimi i dijeve.</i></p> <p><i>Shih: Ev.3-1 Rregullore e programit të studimit, nenet 22-32.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>KUQ harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gimn. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

	<i>shkencore dhe garanton zbatimin e tyre. Procedurat e vlerësimit janë të përputhura me syllabusin</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Format e vlerësimit nga ana cilësore dhe sasiore përcaktohen qartë në rregulloren e Fakultetit të Drejtësisë, të Departamentit të së Drejtës Civile dhe Tregëtare si dhe të programit të studimit me karakter profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ”. Pedagogu i lëndës realizon vlerësimin e studentit mbi njohuritë dhe dijet e fituara sistematikisht dhe ky vlerësim përfshihet në vlerësimin përfundimtar.</p> <p><i>Shih: Ev. 1_4_Rregullore e KU “Qiriazi”, KREU IX, nenet 55-66.</i> <i>Shih: Ev. 3_1_Rregullore e programit të studimit”, neni 22.</i> <i>Shih: Ev. 2_21_Model /template, Teze Kolokiumi.</i> <i>Shih: Ev. 2_21_1 Model /template Teze provimi përfundimtar.</i> <i>Shih: Ev. 2_26_5 Model /template, Formular i vlerësimit të studentit praktikant.</i></p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe risin transparencën.	<p>Gjatë periudhës së pandemisë kanë gjetur zbatim sistemet elektronike të testimit dhe vlerësimit ku është përfshirë edhe kontrolli i dijeve. Përmes tyre dhe portalit të KUQ pedagogët kanë zhvilluar elektronikisht testimet e ndërmjetme të lëndës dhe detyrat e kursit që kanë rezultuar si një formë mjaft e sukseshme e testimit të njohurive.</p> <p><i>Shih: Ev. 1_23_1_Të dhëna për Platformen Moodle</i> <i>Shih: Ev. 1_10_Rregullore e mbrojtjes së të dhënave personale të Kolegjit Universitar “Qiriazi”.</i> <i>Shih: Ev. 1_24_Infrastruktura mësimore e KU “Qiriazi”.</i> <i>Shih: Ev. 1_18_Metodat e mësimdhënies dhe Didaktika në Distancë</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

	<i>Shih: Ev. 1_19_Udhëzues për përdorimin e platformave on-line të mësimdhënies.</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	<p>Format e vlerësimit përfundimtar të lëndës mirëpërcaktohen në instrumentat ligjorë dhe syllabuset për programin e studimit me karakter profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ” dhe vlerësimi përfundimtar realizohet mbi bazën ligjore dhe në përputhje me syllabusin.</p> <p><i>Shih: Ev. 1_4_Rregullore e KU “Qiriazhi”, Kreu IX, nenet 55-66.</i> <i>Shih: Ev. 3_1_Rregullore e programit të studimit, neni 15.</i> <i>Shih: Ev. 2_21_Model /template, Teze Kolokiumi.</i> <i>Shih: Ev. 2_21_1 Model /template Teze provimi përfundimtar.</i></p>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	<p>Vlerësimi i dijeve dhe njohurive realizohet nga pedagogu i lëndës i cili vlerësimin e tij e shoqëron dhe me komentet respektive sipas rastit, vlerësimi dhe komentet respektive realizohen nga pedagogu për çdo pyetje deri në arritjen e një vlerësimi përfundimtar. Pedagogu i lëndës nuk realizon ballafaqimin e rezultateve, por shqyrton vetëm kërkesat apo ankesat të procesit të vlerësimit duke përfshirë të gjithë elementët e vlerësimit të njohurive dhe bën transparent rezultatet e studentit.</p> <p><i>Shih: Ev. 1_4_Rregullore e KU “Qiriazhi”, Kreu IX, nenet 55-66</i> <i>Shih: Ev. 3_1_Rregullore e programit të studimit, neni 32.</i></p>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	<p>KUQ në rregulloren e tij, Statutin, rregulloren e Fakultetit të Drejtësisë, rregulloren e Departamentit të së Drejtës me karakter profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ” përcaktohet kuadri ligjor i shmangies së plagjiaturës/ kopjimit në detyra dhe provime. Nga ana operative ky proces sipas rastit ndiqet nga pedagogu i lëndës, bashkëpunuesve në provim apo komisioneve.</p> <p><i>Shih: Ev. 1_4_Rregullore e KU “Qiriazhi”, Kreu IX, nenet 55-66.</i></p>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	<p>Nga KUQ janë krijuar instrumentat ligjorë dhe praktike për të vlerësuar me meritokraci dhe drejtësi dijet dhe aftësitë profesionale të studentit të programit të studimeve me karakter profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ”. Ky proces mbikqyret nga të gjitha hallkat akademike dhe administrative të njësive përkatëse. Studenti ka të drejtë të sqarohet për paqartësitë që ka lidhur me vlerësimin e tij ashtu siç edhe ka të drejtë të ankimojë rezultatin.</p> <p><i>Shih: Ev. 3_1_Rregullore e programit të studimit</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

	<i>Shih: Ev. 1_4_Rregullore e KU "Qiriazhi", Neni 64.</i>			
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	<p>KUQ garanton të drejtën e ankimimit ndërmjet bazës ligjore në fuqi më specifikisht ndërmjet rregullore së përgjithëshme të KUQ Neni 55 dhe 66 "Ankimimi i studentëve"</p> <p><i>Shih: Ev. 1_4_Rregullore e KU "Qiriazhi", Kreu IX, nenet 55-66.</i></p>			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	<p>Sipas rregullore studentit ka të drejtë të ankimojë vlerësimet e bëra në adresë të tij. Ankimimet dhe kontestimet e rezultateve depozitohen në sekretarinë mësimore e cila më pas i përcjell për administrim në departamentin përkatës. Ankimimet administrohen nga pedagogu përkatës i departamentit i cili shqyrton kërkesat dhe i komunikon sekretarisë dhe rezultatin e rivlerësimit. Në rastet e riankimimit departamenti ngre komision për rishqyrtimin e kërkesave.</p> <p><i>Shih: Ev. 1_4_Rregullore e KU "Qiriazhi", neni 65.</i> <i>Shih: Ev. 3_1_Rregullore e programit të studimit, neni 30.</i></p>			
Konkluzione	<i>KUQ siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. Procedurat e vlerësimit përputhen me syllabusin.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë	Plani mësimor i programit, të studimit me karakter profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ", përgjithësisht, garanton thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve.

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

<p>profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Lëndët që bëjnë pjesë në planin mësimor të programit të studimit përfshijnë njohuri, që japin formimin e përgjithshëm të thelluar, si në fushën ligjore dhe atë të administrimit, por edhe njohuri dhe aftësi të përgjithshme, si anglisht, IT, etj.</p> <p>Pavarësisht sa më sipër, GVJ sygjeron që, përmbajtja e lëndëve të planit mësimor të thjeshtësohet/ ndryshohet dhe ti përshtatet qëllimit dhe natyrës së programit të studimit. Pra studentët të marrin formimin e përgjithshëm bazë dhe atë që ju duhet për të ushtruar këtë profesion.</p> <p>Po ashtu, gjatë vizitës në institucion, u sygjera, që në planin mësimor të shtoheshin disa lëndë, si komunikim, hartim dhe shkrim dokumentacioni, që i përshtaten qëllimit dhe natyrës së programit të studimit, apo apo në lëndët të evidentohet më shumë komponenti praktikë dhe natyra e programit të studimit profesional, - psh. anglishte profesionale.</p> <p><i>Ev. _3_3_Plani Mësimorë.pdf, Ev. _3_4_Veprimtaria formuese e programit.pdf, Syllabuset.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Plani mësimor i programit, të studimit me karakter profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ”, në 59 % të lëndëve të kurikulës e zënë lëndët karakterizuese për zhvillimin e aftësisë në fushën e administrimit, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> E drejtë biznesi; Drejtimit dhe administrimit zyre; E drejtë kushtetuese ; Bazat e marketingut, etj. <p>Në planin mesimor, janë edhe lëndë ndërdisiplinore, që zënë 12% të lëndëve të kurikulës, si dhe lëndë plotësuese.</p> <p><i>Ev. _3_3_Plani Mësimorë.pdf, Ev. _3_4_Veprimtaria formuese e programit.pdf, Syllabuset.</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e</p>	<p>Sipas deklarimeve, kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të vitit shkollor (<i>ne silabus eshte rubrika përmbledhje dhe rezultate e nxënurit</i>).</p> <p><i>Ev. _2_9_Analiza vjetore e DDCT.pdf, Syllabuset</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gimn. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

<p>shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Në vijim të kriterit 3, në përfundim, të çdo lënde pedagogu i bën me dije studentit për modelin dhe formatin e tezës së provimit, që do të përdoret duke e shoqëruar me një listë të pyetjeve, që korespondojnë me çështjet më të rëndësishme të trajtuara në modul. Gjithashtu, pedagogët i informojnë studentët për lidhjen e lëndës përkatëse me shumë lëndë të tjera dhe nga ana tjetër i tregojnë se, ku mund të zbatohen shumë tema të zhvilluara të kësaj lënde në praktikë.</p> <p>Po ashtu, institucioni garanton infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarive praktike në institucion apo jashtë tij, sikurse ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme, ku parashikohet edhe bashkëpunimi në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve, por dhe ka përcaktuar edhe dokumentacionin e fillimit, zhvillimit dhe përmbylljes me sukses të praktikës.</p> <p><i>Ev. _3_6_ Model i dosjes së praktikës.pdf, Ev. _3_9_ Udhëzues i Praktikave.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në Planin e Aktiviteteve të KUQ, por edhe nga deklaratimet e studentëve, një nga pikat është edhe zhvillimi i leksioneve të hapura nga personalitete të ftuara të fushës. Secili pedagog në këtë program studimi, sipas fushës përkatëse që mbulon ka ftuar në leksion një drejtues, specialist etj, i cili ka sjellë përvojën nga biznesi apo zyra noterie/avokatie, aktiviteti i tij, etj.</p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Plani mësimor i programit, të studimit me karakter profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ", përgjithësisht, garanton thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve.</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.</p>	<p>Studentët në programin profesional 2 vjeçar, ALA, diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar. Kolegji Universitar “Qiriazi” organizon tre sezone për provimet e formimit në verë, vjeshtë dhe dimër. Datat e zhvillimit të provimeve sipas sezoneve përkatëse, përcaktohen nga dekani i fakultetit. Programi i provimit të formimit është gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Programi hartohet nga stafi i njësisë bazë, miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit, si dhe Dekani i Fakultetit. Programi shpallet, në ëbsite-n e Kolegjit Universitar “Qiriazi”, dhe u bëhet i ditur studentëve, sipas programit të studimit. Provimi realizohet përpara një komisioni të posaçëm, të përbërë nga pedagogë të departamentit, të fushave që mbulon programi i provimit. Anëtarët e komisionit propozohen nga departamentet përkatëse dhe miratohen nga dekani. Kryetari i komisionit përgjithësisht është Përgjegjësi i Departamentit. Ai respekton në çdo rast, për secilin student procedurën dhe rregullat përkatëse të vendosura nga dekanati. Teza e provimit përmban pyetje nga të gjitha fushat që përfshihen në programin e provimit. Tezat e provimit të formimit kompozohen nga anëtarët e komisionit, të cilët i përzgjedhin pyetjet nga fondi i krijuar në përputhje me peshën specifike të çdo fushe, firmosen nga përgjegjësi i Departamentit dhe miratohen nga Dekani i fakultetit. Provimi organizohet me gojë. Rregullat e tjera që kanë të bëjnë me mënyrën e organizimit të provimit të formimit, përcaktohen në rregulloret e njësive kryesore; f) Rezultatet e provimit të formimit u jepen studentëve në fund të çdo dite provimi. Komisioni, në përfundim të provimit, komunikon vlerësimet e bëra, pret çdo reagim të studentit dhe e sqaron atë në rast kontestimi. Nëse gjatë ballafaqimit konstatohet se është bërë gabim gjatë vlerësimit, bëhet ndryshimi i vlerësimit dhe mbahet një procesverbal. Në përfundim</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

	<p>të procesit të provimit, komisioni hedh rezultatet në sistem, printon procesverbalin i cili firmoset nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Provimit, më pas edhe nga personat e tjerë përgjegjës.</p> <p><i>Ev. 1- 1 Statuti i KU "Qiriazhi", Ev. 2_5_Rregullore e FD.pdf, Ev. 2_7_Rregullore DDCT.pdf, Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Personeli akademik në këtë program studimi është në dispozicion të studenteve lidhur me detyrimet përmbyllëse dhe jo vetëm. Ata ju vënë në dispozicion materialet e nevojshme të kërkuara prej tyre, si dhe ju vendoset në dispozicion një listë me raste studimore dhe pyetje ose ushtrime nga lëndët e profilit. Gjithashtu ju rekomandohen dhe materialet të cilat gjenden në bibliotekën e universitetit, por dhe të fakultet. Në të njëjtë kohë personeli akademik organizon edhe konsultime, nëse studentët e ndiejnë të nevojshme.</p> <p><i>Takimi ne institucion me studentet</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Personeli akademik në këtë program studimi është në dispozicion të studenteve lidhur me detyrimet përmbyllëse dhe jo vetem. Ata ju vënë në dispozicion materialet e nevojshme të kërkuara prej tyre, si dhe ju vendoset në dispozicion një listë me raste studimore dhe pyetje ose ushtrime nga lëndët e profilit. Gjithashtu ju rekomandohen dhe materialet të cilat gjenden në bibliotekën e universitetit, por dhe të fakultet. Në të njëjtë kohë personeli akademik organizon edhe konsultime, nëse studentët e ndiejnë të nevojshme.</p> <p><i>Takimi ne institucion me studentet</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit</p>	<p>Brenda një muaji nga dita e fillimit të vitit akademik, departamenti ju bën të njohur studentëve të vitit të fundit programet e provimit të formimit nëpërmjet Sekretarisë Mësimore dhe asaj të DDCT dhe informojnë studentët rreth organizimit të provimeve të formimit. Në këtë program studimi nuk ka temë përfundimtare, por provim të përgjithshëm formimi.</p> <p><i>Ev. 3_1_Rregullore e programit të studimit.pdf</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

<p>përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	
<p>Kriteri 5. Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të detyrimit përmbyllës, që është provimi i përgjithshëm i formimit, studenti vlerësohet me notë. <i>Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit.pdf, neni 84</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me “Çertifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimit të kryer, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Sipas legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve të institucionit, diplomimi bëhet me provim formimi. Tezat e provimit të formimit hartohen nga departamenti në bashkëpunim me pedagogët e lëndëve. Në përfundim të provimit studenti vlerësohet me notë dhe studenti pajiset me “Diplomë profesionale” në fushën e arsimit të kryer, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin <i>Ev. 3_11_Modeli Diplomë Profesionale.pdf</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet</p>	<p>Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gimn. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	<i>Ev. 1_11_Rregullore për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit.pdf, Ev. 1_12_Rregullore e sekretarisë mësimore.pdf</i>			
Konkluzione	<i>KUQ, ka hartuar dhe ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës. Procesi është publik dhe i bëhet i njohur studentëve</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<p>Në rang institucional KUQ harton cdo vit një plan masash për zbatim nga të gjitha njësitë kryesore dhe ato bazë. Ndër aspektet e ndryshme që janë pjesë e këtij plani masash, ka dhe rubrika për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies.</p> <p>Gjithashtu, në KUQ janë disa udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies, si e-learning, mësim përmes punës, etj.</p> <p><i>Ev. 3_10_ Udhëzues Didaktik.pdf, Ev. 1_19_ Udhëzues për përdorimin e platformave on-line.pdf, Ev. 2_37_2 Udhëzues Marrëdhënia me Partnerët & Biznesin.pdf</i></p>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë	<p>Monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik nga ana e institucionit realizohet në mënyrë periodike si nga strukturat e rektoratit ashtu dhe nga ana e departamentit. Elementet kryesorë që mundësojnë këtë monitorim dhe vlerësim, është realizimi dhe zhvillimi i pyetësorëve të parashikuar në rregulloret përkatëse.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Ky pyetësor realizohet në përfundim të çdo semestri akademik. Gjithashtu, element tjetër që përdoret nga departamenti, është vlerësimi i performancës, ku stafi akademik dokumenton ngarkesën mësimore etj. <i>Ev. _2_26_Paketa e Instrumentave për Matjen e Cilësisë..pdf</i>			
Kriteri 3. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Institucioni në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies ka strukturën përgjegjëse për NJSBC. Misioni i saj përveç funksioneve të tjera është kordinimi dhe monitorimi i gjithë procesit mësimor, plus dhe bërja publike e rezultateve të vlerësimit. <i>Ev. _2_26_Paketa e Instrumentave për Matjen e Cilësisë..pdf, Ev. _2_24_Plani i veprimtarive të NJSBC.pdf, Ev. _2_25_Raporti vjetor i NJSBC.pdf</i>			
Kriteri 4. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	KUQ, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Rastet e specifikuar si pozitive promovohen në strukturat e ndryshme të KUQ. <i>Takimi në institucion, RVB fq. 40</i>			
Konkluzione	<i>KUQ, me kuadrin rregullator të hartuar dhe infrastrukturën që disponon, - salla dhe laboratorë, literaturë, financim për pjesëmarrje në konferenca apo kërkim shkencor, ka incentiva të mjaftueshëm për të nxitur personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
---------------------------------	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

standardeve të fushës III				X
------------------------------	--	--	--	---

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1																																						
Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.																																						
Kriteret	Vlerësimi																																					
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), dokumentacionit bashkëngjitur, deklarimeve të drejtueseve të Fakultetit të Drejtësisë dhe Departamentit të së Drejtës Civile dhe Tregtare, verifikimit të akteve të brendshme të institucionit, në njësitë kryesore të kësaj iaje dhe Fakultetin e Drejtësisë, ku përfshihet edhe programi i vlerësuar, ka të angazhuar personel akademik me përvojën e duhur në fushën e së drejtës dhe ekonomisë. Kjo do të thotë se jo vetëm përmbushen kriteret ligjore formale, si ai i gradës shkencore, titullit akademik dhe eksperiences në punë, por edhe ato materiale, - të njohjes së fushës specifike.																																					
	<table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/grada</th> <th colspan="2">2022-2023</th> <th colspan="2">2023-2024</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof.As.Dr</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>6</td> <td>-</td> <td>8</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>4</td> <td>-</td> <td>4</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Në total</td> <td>12</td> <td>-</td> <td>16</td> <td>-</td> </tr> </tbody> </table>	Tituj/grada	2022-2023		2023-2024		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	1	-	2	-	Prof.As.Dr	1	-	2	-	Dr/PhD	6	-	8	-	Msc	4	-	4	-	Në total	12	-	16	-			
Tituj/grada	2022-2023		2023-2024																																			
	PAE	PAK	PAE	PAK																																		
Prof.Dr	1	-	2	-																																		
Prof.As.Dr	1	-	2	-																																		
Dr/PhD	6	-	8	-																																		
Msc	4	-	4	-																																		
Në total	12	-	16	-																																		

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

	<p><i>CV- të e personelit akademik të brendshëm, Dosjet e personelit akademik të brendshëm, Marrëveshje MAS-KU "Qiriazhi", "Për përcaktimin e numrit të anëtarëve të personelit akademik", Informacion tabelor mbi cilësinë e stafit mësimdhënës sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre për programin e studimit; Të dhëna sipas moshës: Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre, Informacion tabelor mbi numrin e personelit akademik për çdo njësi bazë: (PAE) dhe (PAK), titujt/gradat, Informacion tabelor mbi Planin mësimor lidhur me personelin akademik përkatës për programin e studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), deklarimeve të drejtuesit të Departamentit të së Drejtës Civile dhe Tregtare, deklarimeve të personelit akademik të pranishëm, por edhe verifikimit të akteve të brendshme të institucionit, personeli akademik i brendshëm i kësaj iale, rezulton se, në programin e studimit me karakter profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ" mbulon 100 % të ngarkesës mësimore.</p> <p>Për të ruajtur raportin e shpërndarjes së ngarkesë mësimore në përputhje me kornizën ligjore, 70% për personelin e brendshëm dhe 30% për atë me kohë të pjesshme, GVJ sygjeron rishikim dhe korrigjim të saj për vitin akademik pasardhës.</p> <p><i>Ev. 2- 27- 3 Informacion tabelor mbi Planin mësimor lidhur me personelin akademik përkatës për programin e studimit profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ", Ev. 2- 27 -2 Informacion tabelor mbi numrin e personelit akademik për çdo njësi bazë: (PAE) dhe (PAK), titujt/gradat, Udhëzimi i MAS nr. 29, datë 10-09-2018, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e Arsimit të Lartë"</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë</p>	<p>Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), deklarimeve të drejtueseve të Fakultetit të Drejtësisë dhe Departamentit të së Drejtës Civile dhe Tregtare, deklarimeve të drejtuesit të Burimeve Njerëzore, personelit akademik të pranishëm, vërehet se, jo vetëm të dhënat financiare, e dëshmojnë aftësinë e institucionit për të garantuar qëndrueshmëri, por edhe elementë të tjerë të menaxhimit të personelit, procedura transparente rekrutimi, vlerësimi i</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al


Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

<p>periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>performances i orientuar drejt zhvillimit profesional dhe personal, incentiva të ndryshme motivimi, si: mobiletet, subvencionim i kërkimit shkencore, trajnime, etj</p> <p><i>Ev. 1- 1 Statuti i KU "Qiriazhi", neni 30 dhe 31, Ev. 1_13_1 Procedura e emërimit të stafit akademik në KU "Qiriazhi", Ev. 1-13-4 Kontratë pune, stafin e KU "Qiriazhi", Ev. 2_5_Rregullore e FD.pdf, Ev. 2_7_Rregullore DDCT.pdf, Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit.pdf, Ev. 2_35_1 Vendim për miratimin e fondi KSH.pdf, Ev. 2_35_Vendim i Administratorit për kërkim shkencor.pdf, Ev. 2_11_Vendimi i Senatit Akademik.pdf, Ev. 2_28_2_Trajnim stafi Akademik.pdf, Ev. 2_38_Lista e trajnimeve..pdf, Ev. 1_17_Udhëzues për kualifikimin e stafit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), deklarimeve të drejtuesit të Burimeve Njerëzore, dhe vizitës në institucion, rezulton se, Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programeve të studimit që ofron. Pra, të gjithë elementët e menaxhimit të personelit, duke përfshirë edhe rekrutimin dhe vlerësimin e performances, realizohen jo vetëm formalisht, por edhe në respektim të standardeve, duke garantuar për zgjedhjen dhe mirëmbajtjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programeve të studimit</p> <p><i>Ev. 1- 1 Statuti i KU "Qiriazhi", kreu iv; Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit.pdf, kreu iv; Ev. 1_13_Rregullore e ZBNJ dhe procedura.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në ambientet e Kolegjit, përkatësisht laboratorëve, të cilët përdoren nga studentët, u shoqërua dhe u informua nga personeli ndihmës i Kolegjit, i cili merrej ekskluzivisht me punën e laboratorëve. Kishte laboratorë, klinikë ligjore, etj., në dispozicion të programit të studimit me karakter profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ".</p> <p><i>RVB; Vizita në institucion</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al



<p>mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësakademik dhe administrativ.</p>	<p>Institucioni mbledh, dokumenton dhe përditëson dosjen e personelit akademik të brendshëm dhe të jashtëm dhe koordinatorit të programit çdo vit. Në vizitën e GVJ në Zyrën e Burimeve njerëzore nga vëzhgimi me zgjedhje rastësore të dosjes së një pedagogu të brendshëm dhe një të jashtëm, rezultoi se dosjet e tyre kishin të gjithë dokumentacionin (CV, kontratë punësimi, diploma, certifikata, certifikata trajnimesh, listë botimesh, listë të konferencave, raport mjeksor, dëshmi penaliteti, etj). Mirëpo, rezultoi se në dosjen e personelit mungon i administruar vlerësimi i performancës, pavarësisht se realizohet si proces. GVJ sygjeron se në vijim, pjesë e dosjes së personelit të jenë edhe formulari vlerësimi institucional të performancës apo ai i vetëvlerësimit.</p> <p><i>Vizita në institucion-takimi me drejtues së Zyrës së Burimeve Njerëzore</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera</p>	<p>Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB) dhe deklaratimeve të drejtuesve të Departamentit, Fakultetit të Drejtësisë, vërehet se, pavarësisht se në vitin e tij të dytë, me ndihmën edhe të Zyrës së Këshillimit të Karrierës, janë lidhur memorandume bashkëpunimi me institucione publike, studio ligjore, shoqëri të ndryshme tregtare, duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm me ta, për të garantuar akomodimin e studentëve të këtij programe, në këto institucione dhe për të ftuar ekspertë të fushës në auditor. Po ashtu, vërehet se, prej këtyre marrëveshjeve bashkëpunimi janë krijuar lidhje konkrete ndërmjet kolegjit dhe aktorëve të tregut të punës, në funksion të punësimit të studentëve por edhe për të qenë më pranë nevojave të tregut të punës dhe reflektimit të tyre në programin e studimit.</p> <p>Pavarësisht kësaj, për të garantuar më tej këtë standard dhe ruajtur raportin e shpërndarjes së ngarkesë mësimore në përputhje me</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al




<p>specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>kornizën ligjore, 70% për personelin e brendshëm dhe 30% për atë me kohë të pjesshme, GVJ sygjeron, përfshirjen në këtë program studimi edhe të personelit akademik të jashtëm (kohë e pjesshme).</p> <p><i>Ev. 1 -34 Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit brenda dhe jashtë vendit, Ev. 3- 8 -17 Praktikë profesionale, Ev. 3-6 Modeli i dosjes së praktikës, Ev. 3-9 Udhëzues i Praktikave, Ev.2- 36 Informacion tabelor mbi Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi studimi për Praktikën profesionale me institucionet e tjera shteterore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë, Ev. 3- 7 Organizimi i një vizite mësimore në kuadër të lëndës</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Pavarësisht se, programi i studimit me karakter profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ” është në vitin e tij të dytë të zhvillimit, vërehet se, institucioni garanton infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarive praktike në institucion apo jashtë tij, sikurse ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme, ku parashikohet edhe bashkëpunimi në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve, por dhe ka përcaktuar edhe dokumentacionin e fillimit, zhvillimit dhe përmbylljes me sukses të praktikës.</p> <p><i>Ev. _3_6_ Model i dosjes së praktikës.pdf, Ev. _3_9_ Udhëzues i Praktikave.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. Mirëpo, GVJ sygjeron:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <i>1. Për të ruajtur raportin e shpërndarjes së ngarkesë mësimore në përputhje me kornizën ligjore, 70% për personelin e brendshëm dhe 30% për atë me kohë të pjesshme, rishikim dhe korrigjim të saj për vitin akademik pasardhës;</i> <i>2. Pjesë e dosjes së personelit të jetë edhe formulari vlerësimit institucional të performances apo ai i vetëvlerësimit;</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>KU "Qiriazi" disponon mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike e praktike, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe lëndëve/moduleve përkatëse. KU "Qiriazi" ka një truall me sipërfaqe 5.027,60 m², dhe Godinë me një sipërfaqe prej 3809 m² ndërtim. Një hapsirë, e mjaftueshme për numrin e studentëve që studiojnë në këtë kolegji. Përveç hapsirës së dedikuar për proceset mësimdhënëse dhe administrative, ka mjedise shplothëse, hapësira të gjelbra 400 m², parking 3200 m², mjedise sportive, që përbëhen nga 17700 m². Sipas deklarimeve, lartësia e auditoreve është rreth 3-3.5 m, të cilat plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral. Ambientet nuk përmbajnë elementë të rrezikshëm, si dhe plotësojnë kushtet higjieno-sanitare të nevojshme për të siguruar mbrojtjen efektive të shëndetit të studentëve dhe personelit.</p> <p><i>Ev. 1- 24 Infrastruktura mësimore e KU "Qiriazi", Ev. I -20 Raport vlerësimi (Relacion mbi ambientet mësimore të KU "Qiriazi", Ev. 2- 33 Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit, Ev. 1- 21 Certifikatë për sigurinë nga zjarri: Analiza Mikrobiologjike; Akt-Miratim Higjieno-Sanitar: Dëshmi Shërbimi DDD Dezinfezim, vizita në institucion</i></p>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete	Në KUQ, mjediset ku zhvillojnë procesin mësimor studentët e programit të studimit me karakter profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ", garantonin realizimin e procesit mësimor. Gjatë vizitës GVJ u njoh konkretisht me pajisjen e sallave dhe laboratorëve me smartboard dhe sistemem projektimi digjital, përfshirë edhe të

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

<p>elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>gjitha mjetet e tjera audio dhe video. Laboratorët janë të paisur me kompjutera, printer/fotokopje/skaner, projektor. Institucioni ka një numër të konsiderueshëm laboratorësh dhe një klinikë ligji.</p> <p><i>Vizita e në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), deklarimeve të ndryshme si dhe verifikimeve në terren, në KUQ mësimi zhvillohet në salla leksioni apo seminari të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë, foni dhe internet.</p> <p><i>Vizita e në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), deklarimeve të ndryshme si dhe verifikimeve në terren, KUQ ka në përdorim laboratorë mësimorë informatike të cilët janë në dispozicion edhe për programet e studimit me karakter profesional dhe mjaftueshëm salla mësimore për zhvillimin e procesit akademik (leksione dhe seminare) të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni në rastin e sallave të leksionit.</p> <p><i>Vizita e në institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>KUQ vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

	<i>studimit dhe për formimin praktik, sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), deklarimeve të drejtuesve të Fakultetit dhe Departamentit, dhe personelit akademik të angazhuar, vërehet se, në syllabusin e secilës lëndë, vendoset literaturë bazë dhe ndihmëse, të cilat i lejojnë studentëve marrjen e njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit. Literatura u vendoset studentëve në dispozicion, në mënyrë fizike ose elektronike (në sistemin Moodle) nga pedagogu i lëndës. Biblioteka e KUQ është abonuar në librarinë elektronike Ebsco si edhe në Revistën JSTORE. <i>Silabuset e lëndëve, Ev. _2_20_ Lista dhe kërkesa e pasurimit të teksteve në bibliotekë.pdf, Verifikim ne terren</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Vërehet se, sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), si edhe verifikimeve në terren, 2 Bibliotekat e institucionit, të vendosura në godinën kryesore, me një sipërfaqe prej 45 m ² dhe të pajisura me kompjutera, janë të aksesueshme nga të gjithë studentët në mënyrë të barabartë, përfshirë dhe studentët e këtij programi studimi. <i>Ev. _1_9_Rregullore e brendshme e bibliotekës.pdf, Ev. _2_33_ Të dhëna të plota për infrastrukturën.pdf, Verifikim ne terren</i>
Kriteri 3. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën	Vërehet se, sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), si edhe verifikimeve në terren, 2 Bibliotekat kanë një fond të konsiderueshëm të përbërë nga libra, periodikë, në gjuhë shqipe dhe gjuhë të huaj. Aksesit literaturës së programit nga studentët, garantohej nëpërmjet:

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjimn. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

<p>shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Literaturës fizike në bibliotekë, Aksesit në librarinë elektronike Ebsco, Revistën online JSTORE, Katalogut të librave elektronik e krijuar nga biblioteka, i cili ka në gjuhë të huaj qindra tituj.</p> <p>Si dhe materiale të vëna në dispozicion nga titullarët në sistemin Moodle.</p> <p><i>Ev. _2_20_ Lista dhe kërkesa e pasurimit të teksteve në bibliotekë.pdf, Verifikim ne terren</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), si edhe verifikimeve në terren, abonimi në bibliotekat elektronike apo revistat, dhe kapacitetet infrastrukturore në bibliotekë (PC, ëi-fi, printer) janë për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për të gjithë studentët, pa dallim programi.</p> <p><i>Ev. _1_9_Rregullore e brendshme e bibliotekës.pdf, Verifikim ne terren</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.</p>	<p>Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), si edhe verifikimeve në terren, KUQ ka abonim në bibliotekat elektronike apo revistat, si dhe është i pajisur me kapacitetet infrastrukturore në bibliotekë (PC, ëi-fi, printer).</p> <p><i>Verifikim ne terren</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), si edhe verifikimeve në terren, orari i Bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit që fillon: nga e Hënë- e Shtunë, gjatë orarit 8.00 deri në 17.00.</p> <p><i>Ev. _1_9_Rregullore e brendshme e bibliotekës.pdf, Verifikim ne terren</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 7. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj.</p>	<p>Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), deklarimit të përfaqësuesit të Bibliotekës, si edhe verifikimeve në terren, pasurimi i fondit të bibliotekës është një proces i vazhdueshëm dhe sistematik. Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programeve.</p> <p><i>Ev. _2_20_ Lista dhe kërkesa e pasurimit të teksteve në bibliotekë.pdf, Ev. _1_9_Rregullore e brendshme e bibliotekës.pdf, Verifikim ne terren</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>KUQ për këtë program studimi garanton literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies, po ashtu dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të</p>	<p>Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), deklarimit të drejtuesve, si edhe verifikimeve në terren, KUQ ka deri diku një</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

<p>menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit.</p>	<p>sistem nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët, pedagogët dhe aktivitetin e tyre, kryesisht aktivitetin e tyre akademik, - i cili quhet Moodle. Por, nuk kanë një sistem të mirëfilltë digital menaxhimi, SIMS, i cili të ketë të përfshirë elementë të tillë si, regjistrimi online, pagesa online, zgjedhja e lëndëve online, statistika në kohë reale, etj. Por, kanë deklaruar se kanë hartuar strukturën e një sistemi të përgjithshëm menaxhimi, i cili së shpejti do të fillojë të ndërtohet. Sistemi i ri do të ketë të integruar të gjithë komponentët e menaxhimit digital institucional.</p> <p><i>Ev. _2_22_ Print screen,faqe Moodle.pdf, Verifikim ne terren</i></p> <p>Pavarësisht, numrit të ulët të studentëve dhe kostove të larta, GVJ, sygjeron ndërtimin e këtij sistemi menaxhimi SIMS, duke ja përshtatur nevojave dhe aftësive të KUQ.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), deklarimit të drejtuesve, si edhe verifikimeve në terren, nuk ka një sistem menaxhimi të personelit, ose të ashtëquajturit HRMS. Një sistem digital, i cili ngrihet mbi disa elementë, si rekrutimi, dalja në pension, pagesa, matja e performances, lejet, statistika të ndryshme, etj.</p> <p><i>Ev. _2_22_ Print screen,faqe Moodle.pdf, Verifikim ne terren</i></p> <p>Pavarësisht, kostove të larta, GVJ, sygjeron ndërtimin e këtij sistemi menaxhimi HRMS, duke ja përshtatur nevojave dhe aftësive të KUQ.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Si kemi sqaruar edhe në kriterin nr. 1 dhe 2 më lart, KUQ nuk ka një sistem të mirëfilltë digital menaxhimi për personelin HRMS, apo studentët SIMS. Por, sipas deklarimit të drejtuesve, si edhe verifikimeve në terren, KUQ ka deri diku një sistem nëpërmjet të cilit siguron akses në të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe pedagogët për aktivitetin e tyre akademik, teza provimesh, leksione, etj.- i cili quhet Moodle.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

	<i>Ev. _2_22_ Print screen,faqe Moodle.pdf, Verifikim ne terren</i>			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), deklarimit të drejtuesve, si edhe verifikimeve në terren, KUQ ka një sistem nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët, pedagogët dhe aktivitetin e tyre akademik, - i cili quhet Moodle, i cili garanton një komunikim efektiv pedagog-student. <i>Ev. _2_22_ Print screen,faqe Moodle.pdf, Verifikim ne terren</i> Gjithashtu, kanë një sistem të brendshëm komunikimi intranet, një sistem i hershem komunikimi, që garanton një formë komunikimi pedagog-pedagog, pedagog-personel ndihmës akademik apo administrativ			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Si kemi sqaruar edhe në kriterin nr. 3 më lart, KUQ nuk ka një sistem të mirëfillte digjital menaxhimi për personelin HRMS, apo studentët SIMS. Kjo do të thotë, se me mjetet që disponojnë ka një rrezik për mos monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe pamundësinë për raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. <i>Ev. _2_22_ Print screen,faqe Moodle.pdf, Verifikim ne terren</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit.	Sipas verifikimit faqja zyrtare e KUQ është: https://qiriaz.edu.al/ . Faqja zyrtare përmban informacion të plotë, në shqip, mbi filozofinë dhe misionin, partneret, drejtimin dhe funksionimin, organigramën; guidat për studentët e ardhshëm të Kolegjit si dhe mbi programet, së bashku me bio të detajuara të personelit akademik, etj. https://qiriaz.edu.al/			
Konkluzione	<i>Pavarësisht, numrit të ulët të studentëve dhe kostove të larta, GVJ, sygjeron ndërtimin e sistemi menaxhimi digital institucional, duke ja përshatur nevojave dhe aftësive të KUQ.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

			X	
--	--	--	---	--

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>KUQ është IAL jo publike që zhvillon aktivitetin e tij kryesisht mbi bazën vetëfinancimit dhe/ose financime të tjera. Burimet e financimit dhe menaxhimi i fondeve përcaktohen dhe aprovohen nga Bordi i Administrimit. Po ashtu, veprimtaria kërkimore e shkencore financohet nga vetë universiteti apo edhe nga projekte të ndryshme ku merr pjesë apo edhe donacione të ndryshme legjitime. KUQ harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare. Në raport pasqyrohen të dhëna financiare në lidhje me koston për secilin program studimi, duke bërë kështu edhe një vlerësim të ecurisë dhe vazhdimësisë së programeve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e vendosura, e duke analizuar shpenzimet operationale dhe ato kapitale. Në to përfshihet kosto për çdo program studimi, kostot operationale dhe të mirëmbajtjes, etj. Analiza e kostos së programeve shqyrtohet në raport me të ardhurat që burojnë nga këto programe.</p> <p><i>Ev. 1_23_Kontrata me të tretët.pdf, Ev. 2_34_Projekt buxheti për VA 22-23.pdf, Ev. 1_22_Plani buxhetor.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive</p>	<p>Sipas sqarimeve të dhëna, vërehet se, KUQ ka qëndrueshmëri financiare dhe kapacitete financiare për të përballuar këtë program studimi, por, pasi është program i ri, mbetet të analizohet ecuria e këtij programi studimi dhe kostoja për mbajtjen e tij në të ardhmen, për më tepër nisur nga numri i vogël i studentëve për dy vite akademike.</p> <p>Kështu që GVJ rekomandon që të bëhet vlerësimi financiar mbi kosto-efektivitetin e këtij programi studimi për një planifikim sa më të mirë të kostove të programit të studimit dhe nëse do të vijojë mbështetjen financiare nga Kolegji.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

<p>mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p><i>Ev. 1_23_Kontrata me të tretët.pdf, Ev. 2_34_Projekt buxheti për VA 22-23.pdf, Ev. 1_22_Plani buxhetor.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>KUQ, kryen auditim të pasqyrave financiare çdo vit për të hartohet një raport.</p> <p><i>Ev. 1_23_Kontrata me të tretët.pdf, Ev. 2_34_Projekt buxheti për VA 22-23.pdf, Ev. 1_22_Plani buxhetor.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>KUQ, për të kontrolluar ecurinë dhe vazhdimësinë konform rregullave dhe standardeve, mban të dhëna krahasuese edhe për vitet e kaluara duke bërë të mundur evidentimin e elementeve kryesorë që ndikojnë në performancën e qëndrueshme dhe rezultate të institucionit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon</p>	<p>Nga informacioni dhe vizita institucionale, rezulton se Institucioni ka stabilitet financiar dhe kapacitet financiar për të garantuar në vijim aktivitetin akademik dhe kërkimor-shkencor të tij. Ndarja dhe mënyra e përdorimit të fondeve bëhet duke mbajtur parasysh kërkesat e shprehura prej njësisë/strukturave të Kolegjit, me qëllim arritjen e objektivave, si dhe realizimin e misionit të tij. Në buxhetin vjetor të Kolegjit, parashikohet edhe mënyra e përdorimit të fondeve, të ardhurat dhe shpenzimet e kryera. Të ardhurat e krijuara nga Kolegji përdoren prej tij në funksion të veprimtarisë akademike, administrative e kërkimore-shkencore.</p> <p><i>Ev. 1_23_Kontrata me të tretët.pdf, Ev. 2_34_Projekt buxheti për VA 22-23.pdf, Ev. 1_22_Plani buxhetor.pdf</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.				
Konkluzione	<i>GVJ rekomandon që të bëhet vlerësimi financiar mbi kosto-efektivitetin e këtij programi studimi ALA, për një planifikim sa më të mirë të kostove të programit të studimit dhe nëse do të vijojë mbështetjen financiare nga Kolegji.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Programi i studimit profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ" zhvillohet në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, statutin e KUQ, me rregulloren e KUQ, rregulloren e Fakultetit të Drejtësisë, rregulloren e Departamentit të së Drejtës Civile dhe Tregtare, si edhe rregulloren e programit të studimit. Në këto akte të brendshme, rregullohet zhvillimi i këtij program studimi. Ku përcaktohen të gjitha strukturat, rolet dhe përgjegjësitë përkatëse për mbarëvajtjen e plotë të programit. Këto rregullore ju shërbejnë edhe studentëve të këtij programi studimi për t'u bërë me dije për të drejtat dhe detyrimet e tyre përgjatë gjithë kohës së studimit pranë këtij institucioni.

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

	<p>[<i>Ev. _2_2_Urdhër Nr.384, datë, 08.07.2022.pdf, Ev. _1_1_Statuti KUQ.pdf, Ev. _1_4_Rregullore e Kolegjit.pdf Ev. _2_5_Rregullore e FD.pdf, Ev. _2_7_Rregullore DDCT.pdf, Ev. _3_1_Rregullore e programit të studimit.pdf,</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Referuar statutit dhe rregullores së institucionit, të programit të studimit dhe deklarimeve gjatë vizitës në institucion, dëshmohet se një ndër parimet e funksionimit të KUQ lidhet me faktin se kriteret dhe procedurat në hyrje e deri në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë e më pas studentët e këtij Kolegji. GVJ, vëren se pavarësisht, se ky program është i ri, studentët e tij janë të përfshirë në strukturat studentore apo në vendimmarrje të ndryshme.</p> <p><i>Ev. _2_2_Urdhër Nr.384, datë, 08.07.2022.pdf, Ev. _1_1_Statuti KUQ.pdf, Ev. _1_4_Rregullore e Kolegjit.pdf Ev. _2_5_Rregullore e FD.pdf, Ev. _2_7_Rregullore DDCT.pdf, Ev. _3_1_Rregullore e programit të studimit.pdf, Ev. _2_32_Aktivizimi i studentëve në mbledhje.pdf, Ev. _2_29_Lista e Senatorëve KS.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Kriteret për pranim në program miratohen nga Senati akademik dhe i bëhet me dije QSHA. Referuar nenit 2 të rregullores së transferimeve të studimeve në programet e ofruara nga Fakulteti i Drejtësisë mund edhe të transferohen shtetas të huaj dhe shqiptarë.</p> <p>GVJ e konfirmoi këtë edhe në takimin që zhvilloi me studentët e programit të studimit gjatë vizitës në institucion.</p> <p><i>Ev. _2_12_1_Rregullore e transferimeve.pdf, Ev. _2_12_2_Shembull doc e studentit për transferimet.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit</p>	<p>Krahas të dhënave që jepen në RVB-në e programit të studimit dhe dokumentacionit shoqërues, GVJ konfirmoi ekzistencën e kriterëve e procedurave edhe gjatë vizitës në institucion ku studentët dakortësojnë ekzistencën dhe aksesueshmërinë e të gjithë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

<p>përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>informacionit që lidhet me procedurën që nga pranimi dhe përzgjedhja e studentëve, përparimit përgjatë programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, informacione këto që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p> <p><i>Ev. _2_2_Urdhër Nr.384, datë, 08.07.2022.pdf, Ev. _1_1_Statuti KUQ.pdf, Ev. _1_4_Rregullore e Kolegjit.pdf Ev. _2_5_Rregullore e FD.pdf, Ev. _2_7_Rregullore DDCT.pdf, Ev. _3_1_Rregullore e programit të studimit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Pranimi në Programin e studimit profesional "Asistent Ligjor dhe Administrativ" mbeshetetet në këto kritere:</p> <p>Kriteri i meritës (mesatarja e shkollës së mesme)</p> <p>Kriteri i rëndësisë (koeficienti i profilin të shkollës së mesme, i cili shpallet për çdo vit)</p> <p>Kuotat të paracaktuara nga Kolegji dhe miratuara nga MAS</p> <p>Institucioni dëshmon se nuk aplikon kritere shtesë por zbaton aktet ligjore dhe nënligjore të MAS-it lidhur me përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p> <p><i>Ev. _1_28_Kriteret e pranimit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>GVJ nga dokumentacioni bashkëshoqërues konsaton se KUQ zbaton të gjitha aktet ligjore dhe VKM-të që lidhen me kategoritë e individëve që përjashtohen nga tarifat e shkollimit dhe kushtet e përfitimit të ndihmës/bursave për shtresat në nevojë.</p> <p><i>Ev. _1_25_Vendimi i BA për tarifa dhe bursa.pdf</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

Konkluzione	<i>KUQ ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Në bazë të dokumentacionit të shqyruar, por edhe gjatë takimit me studentët, GVJ konsatoi se që në hyrje të studimeve e deri në diplomim, studentët informohen vazhdimisht mbi çështje të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e tyre të përditshme akademike, si; kriteret e pranimit, procedurat e regjistrimit dhe tarifave, transferimi i studimeve dhe mobilitetet, këshillimin e studentëve, të drejtat e përfaqësimit, veprimtari akademike, kulturore, njoftime, sikurse dhe kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. <i>Ev. 1_1_Statuti KUQ.pdf, Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit.pdf Ev. 2_5_Rregullore e FD.pdf, Ev. 2_7_Rregullore DDCT.pdf, Ev. 3_1_Rregullore e programit të studimit.pdf</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme.	Në KUQ studentët informohen në lidhje edhe me njohjen e kualifikimeve të tyre të mëparshme ose të kryera herët në kohë, sikurse pranohen edhe transferime të studentëve nga institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. E gjithë kjo procedurë është e rregulluar me dokumentacion dhe parashikohet në rregulloren e transferimeve, rregulloren e programit të studimeve si dhe nga Katalogu i KUQ por edhe pranë zyrës së Këshillimit të Karrierës. <i>Ev. 2_38_1 Katalogu i KUQ.pdf</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Informimi i studentëve lidhur me kriteret e proceduarat e vlerësimit të dijeve realizohet në disa forma:</p> <p>Nëpërmjet rregulloreve të KUQ dhe rregullores programit të studimit (kreu IV),</p> <p>Nëpërmjet praktikës së informimit të studentëve të viti të parë,</p> <p>Nëpërmjet personelit akademik në fillim të çdo semestri,</p> <p>GVJ konstaton se informimi i studentëve lidhur me procedurat e vlerësimit është i larmishëm dhe i shtrirë në disa plane. Kjo u konfirmua edhe gjatë takimit me studentë në ditët e vizitës në institucion.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.</p> <p><i>Ev. 3_1_Rregullore e programit të studimit.pdf, neni 34 dhe 35</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Mbështetur në strategjinë e marketingut KUQ planifikon dhe zbaton kalendarin vjetor të aktiviteteve të cilat kanë si qëllim rekrutimin e studentëve të rinj në programet e studimit që ofrohen. Disa prej natyrës së aktiviteteve janë:</p> <p>Turi i promovimeve, që përshin konferencë me maturantët dhe vizitat e stafit në institucionet arimore të arsimit parauniversitar;</p> <p>Ditët e hapura ;</p> <p>Publikimi i Katalogut.</p> <p><i>Ev. 2_38_1 Katalogu i KUQ.pdf, Ev. 2_30_Raport për Open Day 2023.pdf, Ev. 1_35_Marketingu në Kolegjin.pdf, Ev. 1_37_Fletëpalosje e Kolegjit.pdf</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

Konkluzione	<i>KUQ</i> vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	<p>Institucioni ka disa forma të informimit të studentëve përsa i takon njohjes me strukturën dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, si:</p> <p>Nëpërmjet sesionit informues që realizohet në fillim të vitit akademik,</p> <p>Nëpërmjet rregullores së programit të studimit,</p> <p>Nëpërmjet personelit akademik të departamentit,</p> <p>Nëpërmjet faqes së internetit, etj.</p> <p><i>RVB; Vizita në Institucion</i></p>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Që në momentin e regjistrimit, studenti pajiset me programin e studimit që përmban lëndët dhe modulet e tij. Institucioni siguron akses dhe informacion për studentët në lidhje me elementët e programit të studimit që ata ndjekin përmes Katalogut të KUQ, sistemin Moodle dhe personelit akademik që realizon programin.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se Institucioni kontrollon marrjen apo jo të informacionit nga studentët për modulet, lëndët, metodën e vlerësimin dhe detyrat detyrat që zhvillohen gjatë kursit, nëpërmjet pyetësorëve që i realizon në fund të çdo semestri.</p> <p><i>Ev. _2_26_Paketa e Instrumentave për Matjen e Cilësisë..pdf</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni ka disa struktura që adresojnë vënien në kontakt të studentëve me mundësitë e punësimit. Institucioni organizon panairë të tregut të punës, studimin e tregut të punës, marrëveshje bashkëpunimi me sektorin publik dhe privat, si dhe ka strukturën e këshillimit të karrierës që mundëson lidhjen e studentëve me tregun e punës.</p> <p><i>Ev. _2_13_ Studimi i Tregut.pdf, Ev. _2_30_1 Panairi Career Fair 2023.pdf, Ev. _2_37_2 Udhëzues Marrëdhënia me Partnerët & Biznesin.pdf, Ev. _2_36_ Aktivitet në zbatim të marrëveshjeve.pdf, Ev. _1_34_ Marrëveshjet e bashkëpunimit.pdf, Ev. _1_14_ Rregullore e ZMJP&KK.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimet e realizuara u informua mbi sistemin dhe strukturat përgjegjëse për informimin e studentëve mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor. Institucioni, përmes koordinatorit të programit të studimit mban komunikim dhe informon, në mënyra të ndryshme, studentët për njoftimet që lidheshin me procesin mësimor.</p> <p><i>Ev. _2_15_ Vendimi për caktimin e Koordinatorit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni informon studentët mbi praktikatat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Pavarësisht se, programi i studimit me karakter profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ” është në vitin e tij të dytë të zhvillimit, vërehet se, institucioni garanton infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e praktikave profesionale në institucion apo jashtë tij, sikurse ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme, ku parashikohet edhe bashkëpunimi në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve, por dhe ka përcaktuar edhe dokumentacionin e fillimit, zhvillimit dhe përmbylljes me sukses të praktikës.</p> <p><i>Ev. _3_6_ Model i dosjes së praktikës.pdf, Ev. _3_9_ Udhëzues i Praktikave.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>KUQ vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin,</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

	<i>përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Pavarësisht se, programi i studimit me karakter profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ” është në vitin e tij të dytë të zhvillimit, vërehet se, institucioni mban dokumentacionin që lidhet me statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, transferuar, cilësinë në hyrje apo të dhëna të tjera të nevojshme.</p> <p>Në vitin akademik 2022-2023 janë të regjistruar 20 studentë, Në vitin akademik 2023-2024 janë të regjistruar 14 studentë.</p> <p>Totali për dy vitet akademike është 34 studentë.</p> <p><i>Ev. 2_17_Të dhëna Tabelore mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje.pdf , Vizita në institucion-Takimi në sekretarinë mësimore; RVB</i></p>
<p>Kriteri 2. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Në vizitën e realizuar në institucion dhe takimin me sekretarinë mësimore, GVJ iu vu në dispozicion të dhëna që lidheshin me numrin e studentëve të regjistruar në program. Gjithashtu përmes sistemit Moodle apo programit të avancuar excel, institucioni i disponon statistikat në çdo kohë.</p> <p><i>Minutat e Vizitës; Takimi në sekretarinë mësimore; RVB</i></p> <p>Po ashtu, kanë deklaruar se kanë hartuar strukturën e një sistemi të përgjithshëm menaxhimi, i cili së shpejti do të fillojë të ndërtohet. Sistemi i ri do të ketë të integruar të gjithë komponentët e menaxhimit institucional.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritetë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), deklarimeve të drejtueseve të Fakultetit dhe Departamentit, dhe personelit akademik të angazhuar, vërehet se, institucioni mbështetur në akte, kryen kontroll periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritetë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.). Po ashtu, vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p> <p><i>Ev. _1_1_ Statuti KUQ.pdf, Ev. _1_4_ Rregullore e Kolegjit.pdf Ev. _2_5_ Rregullore e FD.pdf, Ev. _2_7_ Rregullore DDCT.pdf, Ev. _3_1_ Rregullore e programit të studimit.pdf, Ev. _2_25_ Raporti vjetor i NJSBC.pdf, Ev. _2_37_ Raport- Plan-Pune ZMJP&KK.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 4. Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), deklarimeve të drejtueseve të Fakultetit dhe Departamentit, dhe personelit akademik të angazhuar, vërehet se, është hartuar raport analitik, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje të studentëve, si dhe shkallën e ndërmjetësimit të tyre për punësim, apo perfitime të tjera.</p> <p><i>Ev. _2_17_ Të dhëna Tabelore mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje.pdf, Ev. _2_9_ Analiza vjetore e DDCT.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni mban dokumentacionin që lidhet me statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, transferuar, cilësinë në hyrje apo të dhëna të tjera të nevojshme.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.5

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Bazuar në Statutin e KUQ, dhe rregullore të tjera, studentët përfshihen në disa struktura drejtuese me karakter mësimor-kërkimor dhe shërbime. Në rastin e programit në fjalë, kemi 1 student në Këshillin Studentor; marrin pjesë në mbledhjet e departamentit, etj.</p> <p>Dokumentacioni shoqërues tregon se KUQ është në zbatueshmëri të Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, dhe garanton se në të ardhmen, me konsolidimin e programit, studentët kanë të drejtë të përfaqësohen në Senatin Akademik, në Bordin e Adminsitrimin, në Komisionin e Etikës, etj.</p> <p><i>Ev. _2_29_Lista e Senatorëve KS.pdf, Ev. _2_32_Aktivizimi i studentëve në mbledhje.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Krahas detyrimeve të përcaktuara në Statut dhe Rreguloren e KUQ, institucioni përdor disa forma të përfshirjes së studentëve në vlerësimin e procesit akademik përmes pyetësorësh në përfundim të çdo semestri.</p> <p>Nga shqyrtimi i disa modeleve pyetësorësh GVJ konstaton se studentëve ju kërkohet të vlerësojnë lëndët e zhvilluara, - lidhja e tyre ose jo me programin; realizimin e orëve mësimore; vlerësimin e performancës së personelit akademik, vlerësimin e materialeve mësimore, etj.</p> <p><i>Ev. _2_26_Paketa e Instrumentave për Matjen e Cilësisë..pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit</p>	<p>Përfshirjen e studentëve në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit në bazë të rregullt vihet re në, realizimin e pyetësorit që iu bëhet studentëve në fund të çdo semestri. Në këtë pyetësor, ka disa pyetje si: “Si e vlerësoni ju cilësinë e prezantimit të leksioneve/ seminareve/etj.”. Në këtë rubrikë studentët</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

<p>të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>nëpërmjet pyetjeve të shtruara në pyetësor japin mendimet e tyre lidhur me:</p> <p>Sa të dobishme janë materialet lëndore; Qartësia e mënyrës së shpjegimit të leksioneve; Qartësia e mënyrës së shpjegimit të seminareve/ushtrimeve; Vlerësimi i rregullsisë së mësimi; Gadishmërinë e pedagogut për tu shpjeguar për pyetjet në lidhje me procesin mësimor; Marrëdhënien e pedagogut në lidhje me kodin e etikës;</p> <p>Po ashtu, ky pyetësor ka edhe një rubrikë <i>Shënim</i>, ku studentit i kërkohet të japë sqarime shtesë, për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies .</p> <p><i>Ev. _2_26_Paketa e Instrumentave për Matjen e Cilësisë..pdf</i></p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me studentët si dhe nga kqyrja e dokumentacionit vërehet se studentëve u mundësohet transparenca dhe barazia në procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Sipas procedurës përkatëse, studenti realizon ankesën pas shpjegimeve gjatë seancës sqaruese me pedagogun e lëndës. Më pas, studenti mund t'i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, për rivlerësimin e komponentit përkatës në tezë., i cili, ose Dekani, nëse ai është vetë pedagogu i lëndës, ngre një komision të përbërë nga 3 pedagogë, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimit.</p> <p><i>Ev. _1_1_Statuti KUQ.pdf, Ev. _1_4_Rregullore e Kolegjit.pdf Ev. _2_5_Rregullore e FD.pdf, Ev. _2_7_Rregullore DDCT.pdf, Ev. _3_1_Rregullore e programit të studimit.pdf,</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>KUQ, përfshin dhe angazhon edhe studentët e programit ALA në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

				X
--	--	--	--	---

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Strukturat përkatëse që realizojnë informimin e studentëve janë sekretaria mësimore, zyra e këshillimit të karrieres dhe marrëdhënieve me jashtë, të cilat ofrojnë shërbim ditor të nevojave për shërbime nga ana e studentëve. Po ashtu, kanë edhe një koordinator të programit. <i>Ev. 1_12_Rregullore e sekretarisë mësimore.pdf, Ev. 1_14_Rregullore e ZMJP&KK.pdf, Ev. 2_15_Vendimi për caktimin e Koordinatorit.pdf</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Rolin e njësisë për këshillimin e karrierës e luan zyra e këshillimit të karrierës, e cila zhvillon veprimtarinë e saj mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin dhe Rregulloret e tjera të KUQ. Format e shërbimit që ofron për studentë janë Informin dhe Orientim profesional siç është informimi për praktika profesionale, mundësi punësimi apo mundësi trajnimi. Gjatë vizitës me përfaqësues të kësaj njësie dhe në takimin me studentët e programit mësuam për orientimin që kjo njësi u jep studentëve për realizimin e praktikave profesionale në institucionet vendase dhe te huaja. <i>Ev. 1_14_Rregullore e ZMJP&KK.pdf, Ev. 2_37_Raport- Plan-Pune ZMJP&KK.pdf</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e	Rolin e njësisë për këshillimin e karrierës e luan zyra e këshillimit të karrieres, e cila zhvillon veprimtarinë e saj mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin dhe Rregulloret e tjera të KUQ. Format e shërbimit që ofron për studentë janë Informin dhe Orientim profesional siç është informimi për praktika profesionale,

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gimn. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

<p>karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>mundësi punësimi apo mundësi trajnimi. Gjatë vizitës me përfaqësues të kësaj njësie dhe në takimin me studentët e programit mësuam për orientimin që kjo njësi u jep studentëve për realizimin e praktikave profesionale në institucionet vendase dhe te huaja.</p> <p><i>Ev. _1_14_Rregullore e ZMJP&KK.pdf, Ev. _2_37_Raport- Plan-Pune ZMJP&KK.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Pavarësisht se, programi i studimit me karakter profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ” është në vitin e tij të dytë të zhvillimit, vërehet se, institucioni garanton infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e praktikave apo punësimin në institucion apo jashtë tij, sikurse ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme, ku parashikohet edhe bashkëpunimi në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve, por dhe ka përcaktuar edhe dokumentacionin e fillimit, zhvillimit dhe përmbylljes me sukses të praktikës.</p> <p><i>Ev. _3_6_Model i dosjes së praktikës.pdf, Ev. _3_9_Udhëzues i Praktikave.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni garanton infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e praktikave apo punësimin në institucion apo jashtë tij, sikurse ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme, ku parashikohet edhe bashkëpunimi në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve, por dhe ka përcaktuar edhe dokumentacionin e fillimit, zhvillimit dhe përmbylljes me sukses të praktikës.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbylljes së standardit</p>	<p>Nuk përmbyllet</p>	<p>Përmbyllet pjesërisht</p>	<p>Përmbyllet kryesisht</p>	<p>Përmbyllet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbylljes së</p>	<p>Nuk përmbyllet</p>	<p>Përmbyllet pjesërisht</p>	<p>Përmbyllet kryesisht</p>	<p>Përmbyllet plotësisht</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

standardeve të fushës V				X
----------------------------	--	--	--	---

Përfundime të Vlerësimit të Programit të studimit me karakter profesional në "Asistent Ligjor dhe Administrativ".

Pikat e forta dhe afirmime

1. Përgjithësisht respektimi i kërkesave të legjislacionit dhe orientimi drejt programeve të studimit me karakter profesional, duke sjellë një program studimi në harmonizim me nevojat e ekonomisë dhe të tregut (Fusha I/ Standardi I.1/ Kriteri 1-6);
2. Infrastruktura bashkëkohore në dispozicion të personelit dhe studentëve për garantimin e një procesi mësimor cilësor (Fusha IV/ Standardi IV.2/ Kriteri 1-4);
3. Realizimi efektiv i programit përmes ndarjes së ngarkesës mësimore, cilësisë së mësimdhënies, vlerësimit të studentëve dhe pedagogëve, realizimit të projekteve praktike, etj (Kryesisht Fusha III);
4. Personel akademik me profesionalizëm dhe integritet, që garanton mësimdhënie cilësore (Fusha IV/ Standardi IV.1/ Kriteret 1-8);
5. Integrimi i vazhdueshëm i mësimimit me praktikën (Fusha II/ Standardi II.4/ Kriteri 3);
6. Planifikimi i karrieres me institucionet vendase dhe të huaja (Fusha V/ Standardi V.6/ Kriteret 1-4);
7. Klimë pozitive bashkëpunimi ndërmjet personelit akademik dhe studentëve;
8. Sigurimi i brendshëm i cilësisë: KU "Qiriazi" ka të mirëpërcaktuar procedurat dhe metodat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional dhe në nivel programesh studimi në përputhje me standartet shtetërore të cilësisë, standartet e udhëzimet përkatëse të cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë dhe atë ndërkombëtare të arsimit të lartë, si dhe të vlerësimit të cilësisë së punës të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Ky sigurim garantohet nëpërmjet NJSBC-së dhe Komisionin për Garantimin e Standardeve të Cilësisë ku nëpërmjet mekanizmave dhe instrumenteve ligjore, disjplinojnë veprimtarinë mësimore, kërkimore

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

shkencore dhe akademike të personelit mësimdhënës, si dhe përcaktimin e një sërë detyrimesh sjelljeje për pedagogët dhe studentët (Fusha I/ Standardi I.3/ Kriteri 1-3).

Pikat e Dobëta

1. Numri i vogël i studentëve;(Standardi V.4,kriteri 1)
2. Rritja e konkurrencës në arsimin e lartë në nivel kombëtar, rajonal dhe më gjerë.

Rekomandime

1. Për të ruajtur raportin e shpërndarjes së ngarkesë mësimore në përputhje me kornizën ligjore, 70% për personelin e brendshëm dhe 30% për atë me kohë të pjesshme, GVJ sygjeron rishikim dhe korrigjim të saj për vitin akademik pasardhës.
2. GVJ rekomandon që, përmbajtja e lëndëve të planit mësimor të thjeshtësohet/ ndryshohet dhe ti përshtatet qëllimit dhe natyrës së programit të studimit. Pra, në planin mësimor të shtohen disa lëndë, si komunikim, hartim dhe shkrim dokumentacioni, apo në disa lëndë të evidentohet më shumë komponenti praktikë.
3. GVJ rekomandon se në vijim, pjesë e dosjes se personelit të jenë edhe formulari vlerësimit institucional të performances apo ai i vetëvlerësimit.
4. Pavarësisht, numrit të ulët të studentëve dhe kostove të larta, GVJ, sygjeron ndërtimin e një sistemi menaxhimi, duke ja përshtatur nevojave dhe aftësive të KUQ.
5. GVJ sygjeron, përfshirjen në këtë program studimi edhe të personelit akademik të jashtëm (kohë e pjesshme).

Evaluation's conclusions for the professional study program " Legal and Administrative Assistant " provided by the Higher Education Institution "Kolegji Universitar Qiriazi"


Strengths and affirmations

1. Generally respecting the requirements of the legislation and orientation towards professional study programs. In harmony with the needs of the economy and the market (Plain I/ Standard I.1/ Criterion 1-6);
2. Contemporary infrastructure available to staff and students to guarantee a quality teaching level (Plain IV/ Standard IV.2/ Criterion 1-4);
3. Effective management of the program through the division of the teaching load, the quality of teaching, the evaluation of students and lecturers, and the implementation of practical projects (Mainly Plain III);

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al



4. Academic personnel with professionalism and integrity, which guarantees quality teaching (Plain IV/ Standard IV.1/ Criterion 1-8);
5. Continuous integration of learning with practice (Plain II/ Standard II.4/ Criterion 3);
6. Career planning with cooperating institutions (Plain V/ Standard V.6/ Criterion 1-4);
7. Positive cooperation climate between academic staff and students;
8. Internal quality assurance: "Qiriazhi" UC has well-defined procedures and methods of internal quality assurance at the institutional level and at the level of study programs by state quality standards, standards, and relevant quality guidelines in the European Area Higher Education and international higher education, as well as the assessment of the quality of teaching work and scientific research. This insurance is guaranteed through the Internal Quality Assurance Unit and the Commission for the Guarantee of Quality Standards, which, through mechanisms and legal instruments, discipline the teaching, scientific, and academic research activity of the teaching staff, as well as the determination of a series of behavioral obligations for lecturers and students (Plain I/ Standard I.3/ Criterion 1-3).

Weakness

1. Small number of students. (Standard V.4,Criterion 1)
2. Increasing competition in higher education at the national, regional, and international levels.

Recommendations

1. To maintain the teaching load distribution ratio following the legal framework, 70% for internal staff and 30% for part-time staff, the External Evaluation Group suggests revision and correction for the next academic year.
2. The External Evaluation Group recommends that the content of the curriculum schedule be simplified/changed and it suits the purpose and nature of the study program. So, in the curriculum, some subjects were added, such as communication, drafting, and documentation writing, that fit the study program and the nature of the study program, or more practical components and the nature of the professional study program should be highlighted in the subjects, for example, professional English.

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



3. External Evaluation Group recommends that the institutional performance evaluation or self-evaluation form be part of the personnel file in the future.

4. Despite the low number of students and high costs, the External Evaluation Group suggests constructing this management system and adapting it to the needs and abilities of "Qiriazi" UC.

5. External Evaluation Group suggests including external academic staff (part-time) in this study program.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

V. STUDENTËT DHE MBËSHETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

